

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5891  
E hënë, 30 shtator 2019  
çmimi 0.40 €

## Kontradiktat e punimeve në Kalanë e Novobërdës

FAQE 10



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", RAGMI MUSTAFA

FAQE 4-5



# NUK KEMI PRITJE TË MËDHA NGA QEVERIA E RE

Lideri i Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH), Ragmi Mustafa, ka bërë me dije se nuk ka përmirësim të gjendjes së shqiptarëve në Luginë të Preshevës. Ai ka thënë se edhe më tutje shqiptarët nuk mund t'i realizojnë të drejtat e veta individuale dhe kolektive. Në

këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Mustafa ka thënë se nuk kanë pritje të mëdha as nga qeveria e ardhshme e Kosovës. Megjithatë, ai ka kërkuar nga qeveria e re që pjesë e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë të bëhet edhe çështja e Preshevës,

Bujanocit dhe Medvegjës. Sipas Mustafës, është treni i fundit që shqiptarët në Luginë të Preshevës ta kenë lirinë e tyre, përkatësisht të bashkohen me Kosovën. Pavarësisht prej vështirësive, ai ka shprehur optimizëm për realizimin e këtij projekti

## OPINION

### DIPLOMACIA, E SËMURA E BALLKANIT F. 10

Prof. Lisen BASHKURTI



## AKTUALE



### THAÇI MERR PJESË NË CEREMONINË E VARRIMIT TË ISH-PRESIDENTIT SHIRAK F. 2

### PJESËMARRJE E ULËT E GRAVE NË AKTIVITETE ZGJEDHORE F. 5

## EKONOMI



### KËTË VIT, 20 MIJË HEKTARË MË SHUMË GRURË F. 9

### PREMTIMET E PARTIVE PËR RRRITJE EKONOMIKE BIEN NDESH ME FMN-në F. 9

## SPORT

### DERBI I DRITËS F.20

### MURIOI: OFERTAT PO MË MOTIVOJNË, DUA TË BËHEM LEGJENDË NË FENERBAHÇE F. 21

## FUSHATA PËR ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE TË 6 TETORIT



### Haradinaj: Rinia e Gjakovës 100 për qind në përkrahje të vizionit tonë për shtetin



### Kurti: Trendi i ikjes do të ndalet përmes shtetit solidar dhe shtetit social



### Limaj: Më 6 tetor të festojmë të gjithë për fitoren e madhe të Nismës dhe partnerëve tanë



### Pacolli: Me AKR-në çdo gjë arrihet vetëm me punë



### Osmani: Kosova do të jetë një dhe e pandashme në qeverisjen time



### Veseli: Me mua kryeministër, bashkatdhetarët nuk do t'i paguajnë polisat e sigurimeve kur vijnë në Kosovë

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Curez-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVE  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Raporti i Parlamentit gjerman: Të fillojë ndjekja penale për blerësit e votave

**TIRANË, 29 SHTATOR** - Bundestagu miratoi të enjten në një debat gjysmë ore, me propozim të dy grupeve parlamentare të koalicionit CDU/CSU dhe SPD, rezolutat për çeljen e negociatave me kushte të anëtarësimit të Shqipërisë me BE-në. Në votimin për Shqipërinë morën pjesë gjithsej 599 deputetë, prej të cilëve 395 votuan pro dhe 188 kundër, ndërsa 16 abstenuan. Të Gjellbrit, iu bashkëngjitën kërkesës së dy partive të koalicionit, CDU/CSU dhe SPD, megjithëse ishin kundër kushteve shtesë të

Bundestagut për Shqipërinë. Ndërkohë që së fundmi është botuar edhe raporti i Bundestagut për kushtet e Shqipërisë, si dhe janë shtjelluar arsyet se pse Gjermania vendosi "Po" me kushte. Në raportin e siguruar nga Faxweb.al iu bëhet thirrje palëve politike në Shqipëri që të bëjnë çdo përpjekje për të siguruar që kjo krizë të kapërcehet sa më shpejt përmes dialogut politik, përndryshe negociatat për pranimin do të bëhen në mënyrë të konsiderueshme më të vështira. Po ashtu theksohet se në vend

duhet të fillojë ndjekja penale kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilët akuzohen për sjellje të ndëshkueshme në procesin e vetingut. Ndërkaq po ashtu kërkohet "fillimi i ndjekjes penale dhe, kur është e përshtatshme, procedurat ligjore kundër atyre që lidhen me blerjen e votave në zgjedhje, dhe ndjekjen serioze dhe me kohë të procedurave". Kërkohet të bëhet më shumë edhe në luftën kundër kanabisit, ku pavarësisht se thuhet se janë bërë përmirësime, Shqipëria mbetet qendra për trafik droge



për tregun evropian. Ndërkohë për zgjedhjet lokale të 30 qershorit thuhet: "Zgjedhjet lokale të 30 qershorit 2019 ishin kryesisht paqësore; megjithatë,

një vendim mbi ligjshmërinë mungon. Kërkon një vendim urgjent të Gjykatës Kushtetuese për ligjshmërinë e këtyre zgjedhjeve".

## Opozita shpreson zgjedhje të parakohshme, qeveria dialog në institucione

Derisa opozita ka vlerësuar se kriza politike mund të kapërcehet me zgjedhje parlamentare dhe vendore në të njëjtën ditë, socialistët i kanë ftuar opozitarët për dialog në institucione, duke theksuar se zgjedhjet e radhës do të mbahen në afatin e parashikuar në fund të mandatit

**TIRANË, 29 SHTATOR** - Partia Demokratike në Shqipëri po përgatit degët e saj për zgjedhje të parakohshme, sipas të dhënave nga një mbledhje e së dielës. Opozita ka vlerësuar se kriza politike mund të kapërcehet me zgjedhje parlamentare dhe vendore në të njëjtën ditë. Socialistët i kanë ftuar opozitarët për dialog në institucione, duke theksuar se zgjedhjet e radhës do të mbahen në afatin e parashikuar në fund të mandatit. Kryesia e Partisë Demokratike të opozitës dhe pjesëtarët e ish-grupit të saj parlamentar mbajtën të dielën një mbledhje, ku u diskutua angazhimi më i madh i strukturave vendore partiake, ka njoftuar voa. Kryetari i kësaj partie, Lulzim Basha, sipas të dhënave nga mbledhja u ka kërkuar gjithë të pranishmëve të shpërndahen sa më shpejt në qarqe dhe të shtojnë e rijetësojnë anëtarësinë e partisë. Basha ka thënë, sipas burimeve të besueshme, se Partia Demokratike duhet përgatitur për zgjedhje të parakohshme par-

lamentare dhe zgjedhje vendore në të njëjtën ditë, ndaj e gjithë partia zbret në terren për takime me qytetarët. Ai ka thënë se kriza e thellë politike e Shqipërisë mund të zgjidhet vetëm nga zgjedhjet e parakohshme. Sipas tij, raporti i OSBE/ODIHR për zgjedhjet vendore dhe rezoluta e Bundestagut janë skanimi i vërtetë i situatës, ndaj zgjidhja e krizës mbetet qëllimi kryesor i opozitës, dhe se kjo vjen vetëm me duke iu drejtuar sovranit me zgjedhje të lira e të drejta. Basha ka shprehur shpresën që deri nga mesi i tetorit nuk do të ketë ndërhyrje negative sa u takon vendimeve të BE-së për fatin e negociatave me Shqipërinë. Por ai ka theksuar se askush të mos ruajë iluzione se aksioni opozitar do të ndërpritet apo se opozita do të tërhiqet, por krahas lëvizjes opozitare, Partia Demokratike ka programin dhe alternativën qeverisëse. Kështu pjesëmarrës në mbledhje kanë lënë të kuptohet se deri më



18 tetor nuk do të ketë protesta, ndonëse kërkesa dhe gatishmëria e qytetarëve është e lartë, se së shpejti ka zgjedhje të parakohshme me një qeveri transitore dhe se degët e partisë duhet të përgatiten. Krahas pritshmërive nga BE-ja për integrimin, një tjetër arsye pse Partia Demokratike po ruan durimin në këtë periudhë është edhe klima e brishtë e dialogut që sapo nisi në tryezën e organizuar nga OSBE-ja për reformën zgjedhore. Pra, pezullimi i protestave erdhi për shkak të dialogut për reformën zgjedhore.

Pjesëmarrës në mbledhjen e PD-së pohuan se opozita e sheh reformën zgjedhore si hapi i parë për zgjidhjen e krizës politike dhe zgjedhje të parakohshme, ndaj nuk dëshiron të fajësohet për dëmtimin e këtij procesi dialogu. Partia Demokratike ka thënë se komisioni parlamentar i reformës zgjedhore është jolegjitim, dhe ajo propozon një komision me përfaqësues nga partitë kryesore dhe pjesëmarrjen e përfaqësuesve ndërkombëtarë. Krahas këtyre, Partia Demokratike po punon për një paketë anti-krizë, që mban në

qendër të vëmendjes luftën ndaj kimit dhe rritjen e ekonomisë. Opozita ka vlerësuar se kriza politike është e thellë shumëplanëshe dhe nuk duhet humbur kohë me përgatitjet parazgjedhore, ndaj po ngre një shtab elektorale në qendër, i cili do të shtrihet në gjithë vendin. Shumica socialiste ka hedhur poshtë kërkesat e opozitës për një komision për reformë zgjedhore me pjesëmarrje të ndërkombëtarëve, dhe i fton opozitarët për dialog në institucione, duke mohuar edhe praninë e një krize politike në kryeqytet.

## Thaçi merr pjesë në ceremoninë e varrimit të ish-presidentit Shirak

**PRISHTINË, 29 SHTATOR** - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka udhëtuar të dielën për në Paris, ku do të marrë pjesë në ceremoninë e varrimit të pres-

identit të 22-të të Republikës së Francës, Jacques Chirac. Sot (e hënë) është shpallur ditë zie në Francë. Në këtë ceremonitë mortore do të marrin pjesë rreth 30 burrështetas nga

e tërë bota. Presidenti Thaçi e pati vlerësuar ish-presidentin Chirac një prej figurave të mëdha të politikës botërore që i doli në ndihmë Kosovës në ditët më të

vështira, sidomos në Konferencën e Rambouillet dhe përkrahjen për bombardimin e caqeve të Policisë dhe Ushtrisë serbe në vitin 1999.



# Vazhdojnë aderimet nëpër parti politike edhe gjatë fushatës



Në ditën e pestë të fushatës zgjedhore subjektet politike kanë prezantuar aderimet e reja. Profesori dhe ish-kandidati i AAK-së për deputet, Imer Rusinovci, i është bashkuar Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), ndërkaq Arbënore Berisha-Bicaj, doktoreshë e shkencës në lëmin e pedagogjisë, i është bashkuar Lëvizjes Vetëvendosje, kurse Nismës Socialdemokrate i janë bashkuar 100 familje në Deçan

dielën Arbënore Berisha-Bicaj si anëtarin më të re të kësaj lëvizje. Ai ka thënë se Berisha-Bicaj, e lindur në Prishtinë, është nënë e dy fëmijëve dhe bartë titullin e doktoreshës së shkencave në lëmin e pedagogjisë. "Për 13 vjet ajo ka koordinuar programin më të madh në fushën e zhvillimit profesional dhe të kualifikimit të mësimit në vend, programin AKM në kuadër të

realizimit të programit që avancojnë arsimin dhe e ndërlikojnë atë me ekonominë. Kurse Nismës Socialdemokrate të dielën në Deçan i janë bashkuar 100 familje nga kjo komunë. Me këtë rast, kryetari i Këshillit Kombëtar, Jakup Krasniqi, iu ka uruar mirëseardhje atyre në emër të Nismës, duke shtuar se partitë socialdemokrate janë ato që kanë bërë progres në shtetet e

botës, e që sot të njëjtat janë shtete të së drejtës. Ai ka thënë se Nisma ka zgjedhur gjuhën e kulturuar e jo të konfrontimit në zgjedhjet e 6 tetorit. Krasniqi ka theksuar se kjo gjuhë e cila ka sjellë lirinë, do ta sjellë edhe ndërtimin e shtetit të së drejtës. "Ne socialdemokratët e ndjekim një rrugë tjetër. Ne e kuptojmë se sistemi demokratik vlerë të saj e ka konkurrencën, konkurrencën për të treguar në qeverisje, konkurrencën për të treguar në përfaqësim dhe pasi është kjo ne e kemi zgjedhur jo gjuhën e konfrontimit, jo gjuhën e akuzave, por një gjuhë më të kulturuar, një gjuhë që nuk e vret dhe nuk e fyen askënd. Pra, një gjuhë e cila thotë nëse së bashku e kemi sjellë lirinë, atëherë edhe së bashku duhet ta ndërtojmë shtetin e së drejtës", ka thënë Krasniqi.

Të shtunën Nismës i është bashkuar edhe kampioni i shumëfish të botëror në kik-boks, Azem Maksutaj, nipi i Dervish Shaqes.



## **EPOKA E RE** Muhamet KOCI

**PRISHTINË, 29 SHTATOR** - Subjektet politike kanë vazhduar t'i përforcjnë radhët e veta me njerëz të rinj edhe gjatë fushatës zgjedhore. Në ditën e pestë të fushatës, profesori dhe ish-kandidati i AAK-së për deputet, Imer Rusinovci, i është bashkuar Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Kryetari i PDK-së dhe kandidati për kryeministër, Kadri Veseli, ka thënë se së bashku me Rusinovcin do ta zhvillojnë

bujqësinë e Kosovës. "Një prej ekspertëve më të mirë bujqësor në vendin tonë, ish-kandidati i AAK-së për deputet, profesori Imer Rusinovci, prej sot është pjesë e Partisë Demokratike të Kosovës. Mirë se erdhe në familjen tonë politike, Imer! Bashkë do ta zhvillojmë bujqësinë. Bashkë do ta ndërtojmë të ardhmen, për çdo qytetar, për shtetin tonë", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe kandidati për kryeministër i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka prezantuar të

Universitetit të Prishtinës, MASH-it dhe Fakultetit të Edukimit që ka shënuar një kthesë të rëndësishme në reformimin e arsimit dhe shkollave në Kosovës. Arbënorja ka punuar ligjëruese e jashtme në Universitetin e Prishtinës, ligjëruese e rregullt në disa kolegje dhe universitete private në vend", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook". Sipas tij, Berisha-Bicaj do të sjellë një profesionalizëm dhe përvojë të rëndësishme në lëvizje duke e shtuar kështu hapin drejt



# IKD-ja: Vërtetimi për të kaluarën kriminale, cenim i sigurisë juridike

**PRISHTINË, 29 SHTATOR (ER)** - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka bërë me dije se vërtetimi për të kaluarën kriminale i cili u kërkohet qytetarëve është cenim i drejtëpërdrejtë i sigurisë juridike.

Zyrtarët e këtij instituti të dielën kanë thënë se ky është vlerësimi që ka dalë nga analiza e legjislacionit dhe praktikave rreth lëshimit të vërtetimeve nga Policia e Kosovës.

Autori i kësaj analize, Gëzim Shala, ka thënë se evidencat penale të cilat mirëmbahen dhe shfrytëzohen në Kosovë cenojnë sigurinë juridike dhe shkelin të drejtat e njeriut nga vetë organet e drejtësisë dhe

sigurisë. "Duke mos interpretuar drejt dispozitat ligjore në kuadër të sistemit unik juridik të Kosovës, në fushën e lëshimit të certifikatave për të kaluarën kriminale është krijuar dualizëm mes sistemit gjyqësor dhe Policisë së Kosovës. Rezultat i këtij dualizmi është cenimi i skajshëm i sigurisë juridike të qytetarëve dhe personave juridikë të Republikës së Kosovës", ka theksuar Shala.

Ndërsa Yll Zekaj ka paraqitur disa prej rekomandimeve të IKD-së, duke kërkuar që institucionet ta ndalojnë vënien e obligimit për t'u pajisur me të ashtuquajturën certifikatën e së kaluarës kriminale. Sipas tij, në



secilin proces apo procedurë e cila zhvillohet pranë këtyre institucioneve, e mjaftueshme është certifikata e lëshuar nga gjykatat. "Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet ta ndryshojë

Rregulloren për Mbajtjen e Evidencave Penale dhe të njëjtën ta harmonizojë me Kodin e Procedurës Penale në mënyrë që mos të krijohen pasoja të dënimit me gjobë", ka

thënë Zekaj. Po ashtu, IKD-ja ka kërkuar prej Avokatit të Popullit të dalë me një raport "ex-officio" dhe t'i rekomandojë Policisë së Kosovës ndalimin e lëshimit të këtyre certifikatave.

Flet për "Epokën e re", Ragmi Mustafa

# Nuk kemi pritje të mëdha nga qeveria e re

Lideri i Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH), Ragmi Mustafa, ka bërë me dije se nuk ka përmirësim të gjendjes së shqiptarëve në Luginë të Preshevës. Ai ka thënë se edhe më tutje shqiptarët nuk mund t'i realizojnë të drejtat e veta individuale dhe kolektive. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Mustafa ka thënë se nuk kanë pritje të mëdha as nga qeveria e ardhshme e Kosovës. Megjithatë, ai ka kërkuar nga qeveria e re që pjesë e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë të bëhet edhe çështja e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës. Sipas Mustafës, është treni i fundit që shqiptarët në Luginë të Preshevës ta kenë lirinë e tyre, përkatësisht të bashkohen me Kosovën. Pavarësisht prej vështirësive, ai ka shprehur optimizëm për realizimin e këtij projekti



## **EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 29 SHTATOR** - Kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH), Ragmi Mustafa, ka thënë të dielën se edhe më tutje shqiptarët në Luginë të Preshevës nuk mund t'i realizojnë të drejtat e tyre individuale dhe kolektive. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka bërë me dije se nxënësve të arsimit fillor dhe të mesëm u mungojnë tekstet shkollore në gjuhën shqipe. "Përdorimi i lirë i simbolit kombëtar është mollë e ndaluar, po ashtu është i cunuar përdorimi i gjuhës dhe shkrimit shqip si gjuhë zyrtare në Preshevë, Medvegje dhe Bujanoc. Tani certifikatat e lindjes merren vetëm me shkrimin civil edhe për shqiptarët dhe kjo është shkelje e të drejtave individuale. Zhvillimi ekonomik në Luginë të Preshevës është duke ngecur sepse nuk ka investime. Nuk ka perspektivë për rininë e cila në masë të madhe është duke shkuar drejt Evropës. Shqiptarëve të Luginës nuk u njihen nga Serbia as diplomat e universiteteve të Kosovës, kurse serbëve në Kosovë u njihen diplomat edhe nga universitetet paralele", është shprehur Mustafa.

Ai ka thënë se nuk kanë pritje të mëdha as nga qeveria e ardhshme e Kosovës meqë ajo do të drejtohet nga subjektet që kanë qeverisur edhe më herët. "Qeveria e re pritet të drejtohet nga subjektet që kanë qeverisur edhe në të kaluarën, prandaj pritet tona nuk janë shumë të mëdha, por dëshirat tona janë miliona herë më të mëdha sesa pritet. Është kruciale që në procesin e bisedimeve në mes të Prishtinës dhe Beogradit duhet të vendoset zgjidhja e problemit të shqiptarëve në

Luginë të Preshevës", ka theksuar Mustafa, duke shtuar se Lugina përfundimisht duhet të bëhet pjesë e dialogut dhe në kuadër të marrëveshjes përfundimtare të përfshihet edhe bashkimi i Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës me Kosovën. "Prandaj është momenti i fundit që Presheva, Bujanoci dhe Medvegja të bëhen pjesë e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë pas zgjedhjeve të 6 tetorit. Në marrëveshjen përfundimtare në mes të dy vendeve duhet të përfshihet edhe bashkimi i Luginës së Preshevës me Kosovën", ka thënë ai. Pavarësisht prej vështirësive, Mustafa ka shprehur optimizëm, duke thënë se beson 99 për qind në realizimin e këtij projekti.

**"Epoka e re":** Z. Mustafa, a ka përmirësim të gjendjes së përgjithshme në Luginë të Preshevës?

**Mustafa:** Gjendja e shqiptarëve në Luginë të Preshevës nuk ndryshon prej kohësh sepse asnjë qeveri e Serbisë nuk ka qenë e interesuar ta përmirësojë gjendjen e shqiptarëve dhe realizimin e të drejtave të tyre individuale dhe kolektive. Edhe më tutje nxënësve të arsimit fillor dhe të mesëm u mungojnë tekstet shkollore në gjuhën shqipe. Përdorimi i lirë i simbolit kombëtar është mollë e ndaluar, po ashtu është i cunuar përdorimi i gjuhës dhe shkrimit shqip si gjuhë zyrtare në Preshevë, Medvegje dhe Bujanoc. Tani certifikatat e lindjes merren vetëm me shkrimin civil edhe për shqiptarët dhe kjo është shkelje e të drejtave individuale. Zhvillimi ekonomik në Luginë të Preshevës është duke ngecur sepse nuk ka investime. Nuk ka

perspektivë për rininë e cila në masë të madhe është duke shkuar drejt Evropës. Shqiptarëve të Luginës nuk u njihen nga Serbia as diplomat e universiteteve të Kosovës, kurse serbëve në Kosovë u njihen diplomat edhe nga universitetet paralele.

**"Epoka e re":** Ka qenë e pamjaftueshme ndihma që keni marrë nga Kosova dhe Shqipëria?

**Mustafa:** Nuk ka pasur ndonjë investim të madh nga dy qeveritë shqiptare. Gjatë mandatit të tij ministri i Arsimit, Arsim Bajrami, ka sjellë 104 mijë ekzemplarë të teksteve që ishte gjest i shkëlqyer, por ato tekste për shtatë muaj u mbajtën në doganën serbe dhe asnjëherë nuk u lejuan të vijnë në duart e nxënësve meqë u kthyen mbrapa. Një ndihmë tjetër ka qenë edhe për maternitetin ku Qeveria e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë i kanë dhënë nga 50 mijë euro. Nga qeveria e fundit e Kosovës kanë qenë disa investime të vogla në Bujanoc por, megjithatë, ato janë të mirëseardhura për shqiptarët, sepse përmes këtyre investimeve ndërtohet një besueshmëri se ka kujdes të veçantë për shqiptarët. Ato investime janë në vlerë 30-40 mijë euro apo 50-60 mijë euro, mirëpo e kuptojmë se buxheti i Kosovës nuk është aq i madh sa për t'i ndihmuar shqiptarët në bazë të nevojave që kanë. Serbia investon miliona euro brenda një viti në Kosovë për serbët, prandaj një sjellje reciproke duhet të jetë edhe prej Shqipërisë dhe Kosovës, pra të kujdesen për shqiptarët siç kujdeset Serbia për serbët.

**"Epoka e re":** Aktualisht Kosova ndodhet në proces zgjedhor. Cilat janë pritjet e Luginës së Preshevës nga qeveria e re në raport me shqiptarët e asaj pjese?

**Mustafa:** Qeveria e re pritet të drejtohet nga subjektet që kanë qeverisur edhe në të kaluarën, prandaj pritet tona nuk janë shumë të mëdha, por dëshirat tona janë miliona herë më të madhe sesa pritet. Është kruciale që në procesin e bisedimeve në mes të Prishtinës dhe Beogradit duhet të vendoset zgjidhja e problemit të shqiptarëve në Luginë të Preshevës. Lugina përfundimisht duhet të bëhet pjesë e dialogut dhe në kuadër të marrëveshjes përfundimtare të përfshihet edhe bashkimi i Luginës me Kosovën.

**"Epoka e re":** Si e shihni ecurinë dhe epilogun e këtij procesi gjatë mandatit të qeverisë së re?

**Mustafa:** Dialogu në mes të dy popujve dhe dy shteteve të cilat kanë problem nuk ka alternativë, sepse kemi provuar zgjidhjen e problemeve edhe me luftëra dhe dihen dëmet që janë shkaktuar. Prandaj dialogu nuk mund të zëvendësohet me asnjë mjet tjetër për zgjidhjen e problemeve. Në këtë drejtim presim që përfundimisht të arrihet një marrëveshje me mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) të cilat duhet të jenë garantuese të fuqishme për zbatimin e marrëveshjes. Nëse Amerika është garantuese e zbatimit të marrëveshjes, atëherë nuk ka pse të hezitohet dhe të pritet më gjatë, sepse ShBA-ja asnjëherë gjatë historisë nuk i ka mashtruar shqiptarët dhe nuk ka vendosur në dëm të tyre.

Edhe në këtë rast nuk ka arsye për të mos i besuar Amerikës kur pritet një zgjidhje e mirë, aq më tepër kur mbështetet bashkëngjitja e Luginës së Preshevës me Kosovën. Është treni i fundit që shqiptarët në Luginë të Preshevës ta kenë lirinë e tyre, përkatësisht të bashkohen me Kosovën.

**"Epoka e re":** Nëse nuk ndodh ky bashkim, të paktën prisni që përmirësimi i të drejtave të shqiptarëve në Luginë të Preshevës të jetë një prej pikave të marrëveshjes përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë?

**Mustafa:** Jo, asnjëherë. Ajo mund të jetë e shënuar në cilindo dokument, por Serbia nuk do ta zbatojë. Serbia asnjëherë nuk i ka zbatuar marrëveshjet, ligjet dhe Kushtetutën kur kanë qenë në pyetje të drejtat dhe interesat e shqiptarëve. Një moszgjidhje e problemit të shqiptarëve në Luginë të Preshevës hap rrugë që shqiptarët të migrojnë edhe më shumë. Prandaj është momenti i fundit që Presheva, Bujanoci dhe Medvegja të bëhen pjesë e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë pas zgjedhjeve të 6 tetorit. Në marrëveshjen përfundimtare në mes të dy vendeve duhet të përfshihet edhe bashkimi i Luginës së Preshevës me Kosovën.

**"Epoka e re":** Pavarësisht dëshirës, sa janë gjasat reale që të ndodhë një gjë e tillë?

**Mustafa:** Unë dhe Partia Demokratike Shqiptare (PDSH) në Luginën e Preshevës e dëshiron, e mbështet dhe beson 99 për qind për realizimin e këtij projekti.

# Osmani: Kosova do të jetë një dhe e pandashme në qeverisjen time

PRISHTINË, 29 SHTATOR (ER) - Kandidatja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për kryeministre, Vjosa Osmani, para mijëra simpatizantëve në Vushtrri ka thënë të dielën se gjatë qeverisjes së saj Kosova do të jetë një dhe e pandashme. "LDK-ja, ashtu siç ndërtoi themelet e këtij shteti, ashtu do ta mbrojë këtë shtet në kufijtë ekzistues. Më 6 tetor, me mbështetje qytetare, ne do t'i dërgojmë në opozitë të gjatë ata që e kanë krijuar

modelin e zhatjes dhe nëpërkëmbjes së shtetit, pra PDK-në. Do t'i dërgojmë në opozitë njëherë e mirë duke ua kthyer qytetarëve të Kosovës shpresën për ditë më të mira në këtë shtet", ka deklaruar Osmani, duke shtuar se LDK-ja është parti që bazën e ka te lidhja me qytetarët. "Ashtu siç e keni rikthyer LDK-në në pushtet në Vushtrri, kur të tjerët nuk e besonin një gjë të tillë, ashtu do ta kthejmë LDK-në në

pushtet edhe në qeveri. Dëshmojani të gjithëve më 6 tetor që fitorja jonë jo vetëm se është e mundur, por do të jetë aq e thellë sa që nuk do t'i lusim të tjerët që të vijnë me neve në qeveri. LDK-ja angazhohet për shtet të pavarur e sovran dhe në miqësi me ShBA-në. Vushtrria nuk i do të tillët që Amerika thoshte se ua kanë ngulur thikën pas shpinës. Me mua si kryeministre Kosova nuk do ta humbasë asnjë centimetër të

territorit të Kosovës dhe askush nuk mund të formojë shtet mbi shtetin e Kosovës", është shprehur Osmani. Kurse nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, ka thënë se LDK-ja e ka ndërruar standardin e mbajtjes së tubimeve sepse ka dalë nga sallat në sheshet e qyteteve për shkak të masivitetit të pjesëmarrjes. Ndërsa kryetari i Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka thënë se ky qytet, i cili identifikohet me Hasan Prishtinën dhe Ahmet

Krasniqin, sikur dy vjet më parë, edhe më 6 tetor do ta bëjë ndryshimin e madh në nivel të Kosovës. Po të dielën kandidatja e LDK-së për kryeministre, Vjosa Osmani, ka prezantuar programin e saj në fushën e arsimit, me ç'rast ka thënë se arsimit do të jetë prioritet i lartë. Kandidatja për kryeministre e LDK-së, Vjosa Osmani, fushatën zgjedhore të dielën e ka vazhduar edhe në Drenas, Mitrovicë dhe Prishtinë.



## Pjesëmarrje e ulët e grave në aktivitete zgjedhore

PRISHTINË, 29 SHTATOR (ER) - Demokracia në Veprim (DnV) është duke vëzhguar fushatën zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme të 6 tetorit në nivel vendi. Gjithsej 72 vëzhgues janë në terren duke vëzhguar dhe raportuar për mbarëvajtjen, aktivitetet dhe për shpenzimet e subjekteve politike që po garojnë për zgjedhje. Gjatë treditëshit të parë të fushatës zgjedhore janë vëzhguar gjithsej 217 aktivitete të subjekteve politike, pjesa më e madhe e të cilave kanë qenë tubime publike. Trendi i tubimeve publike ka vazhduar përgjatë tre ditëve të fushatës si një metodë që partitë politike kanë zgjedhur për t'i përçarur mesazhet e tyre ndaj një pub-

liku më të madh. Sipas DnV-së, nuk kanë munguar as format e tjera të bërjes fushatë, ku subjektet politike kanë organizuar vizita derë me derë (në 11 raste), kanë mbajtur takime me grupe të shënjestruara (në 13 raste) si dhe kanë vendosur tezga në hapësira publike (në 8 raste). Subjektet politike në tri ditët e para të fushatës kanë përdorur gjuhë që nxit urrejtje, gjuhë fyese kundër subjekteve të tjera politike të cilat garojnë në këto zgjedhje. Në disa takime fjalët 'hajni, njeri i lig, njeri i territ, ka vjedhur, kriminel etj.' janë përdorur për ta akuzuar njëri-tjetrin. Kryesisht gjuha nxitëse që çon në urrejtje ka bazë politike. Në aktivitete zgjedhore të moni-



toruara në 11 raste mesazhet e dhëna gjatë aktivitetit kanë

përmbajtur gjuhë që nxit urrejtje. "Pjesëmarrja e ulët e grave

në aktivitete zgjedhore ka përcjell të gjitha proceset zgjedhore në Kosovë pavarësisht preorgativave ligjore dhe kushtetuese të cilat garantojnë barazi gjinore. Në aktivitete zgjedhore që u monitoruan nga DnV në total folës ishin 798 persona, prej të cilëve raporti gjinor i pabarabartë në mes të grave dhe burrave mbetet i njëjtë që nga dita e parë. Në tri ditët të fushatës zgjedhore folës ishin 77 për qind burra dhe 23 për qind gra. Ndërsa në 2 raste folës kanë qenë personat me aftësi të kufizuara, përkatësisht në Malishevë, në aktivitete të ndara të koalicionit NISMA-AKR-PD dhe LDK", është thënë në njoftimin e DnV-së.

# Limaj: Më 6 tetor të festojmë të gjithë për fitoren e madhe të Nismës dhe partnerëve tanë

PRISHTINË, 29 SHTATOR (ER) - Kandidati për kryeministër i koalicionit Nisma-AKR-PD, Fatmir Limaj, ka vazhduar fushatën elektorale në Komunën e Klinës, ku ka deklaruar se qytetarët në gjithë Kosovën po e mirëpresin vizionin bashkë për shtetin. Ai ka thënë se si asnjëherë më parë Kosova ka nevojë të jetë e bashkuar sepse, sipas Limajt, si rezultat i bashkimeve të kohë-paskohshme ka pasur rezultate të fuqishme për vendin dhe kombin. "Si asnjëherë më parë Kosova ka nevojë me qenë e bashkuar. Qytetarët duan ta shohin një shtet të fortë dhe të fuqishëm. Një shtet social, një shtet që hap vende të punës, një

shtet ku mbrohen të drejtat e punëtorit dhe një shtet që kujdeset për të gjithë. Këto mund të bëhen kur jemi të bashkuar. Sa herë që Kosova dhe shqiptarët janë bashkuar kanë arritur rezultate. Në fakt, si rezultat i bashkimeve të kohë-paskohshme kemi sjellë rezultate të fuqishme për vendin dhe kombin tonë. Koha është për t'u bashkuar për shtetin, temat që na presin mund t'i zgjidhim vetëm të bashkuar", është shprehur Limaj.

Ai u bërë thirrje qytetarëve që më 6 tetor ta votojnë koalicionin Nisma-AKR-PD dhe kandidatët për deputetë nga kjo anë. Qytetarët e Klinës duhet të angazhohen që ta kthejmë në



festë këtë fushatë elektorale dhe më 6 tetor të festojmë të gjithë për fitoren e madhe të Nismës

dhe partnerëve tanë", ka thënë Limaj. Nisma Socialdemokrate të

dielën ka vazhduar fushatën zgjedhore edhe në Gjakovë dhe Pejë.



## Pacolli: Me AKR-në çdo gjë arrihet vetëm me punë

Ndërkaq partneri tjetër i koalicionit Nisma-AKR-PD, kryetari i Aleancës Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli, ka vazhduar fushatën zgjedhore në Pejë. Para qytetarëve të pranishëm ai është zotuar se do të punojë që të rinjtë mos të zhgënjehen

nga vendi i tyre. Ai ka thënë se me AKR-në çdo gjë arrihet vetëm me punë. "Nuk do të doja asnjëherë që ju rini të zhgënjeheni. Peja ka bukuri natyrore që të tjerat nuk i kanë. AKR-ja është një parti ndryshe nga të tjerat, çdo

arritje e shih nëpërmjet punës dhe jo fjalëve boshe", ka deklaruar Pacolli. Në këtë aktivitet elektorale Pacolli ka qenë i shoqëruar nga kandidatët e tjerë për deputet, Ekrem Mustafa dhe Islam Pacolli.

## Haradinaj: Rinia e Gjakovës 100 për qind në përkrahje të vizionit tonë për shtetin

PRISHTINË, 29 SHTATOR (ER) - Kandidati për kryeministër i koalicionit AAK-PSD, Ramush Haradinaj, të dielën ka mbajtur tubim elektorale në Gjakovë, ku ka bashkëbiseduar me të rinjtë e kësaj komune. Ai ka thënë se rinia e Gjakovës 100 për qind është në përkrahje të vizionit të këtij koalicioni për shtetin. Haradinaj ka thënë se kujdesi për rininë është garanci për ndërtimin e një shoqërie të sigurt dhe me rritje ekonomike. "Rinia e Gjakovës është 100 për qind në përkrahje të vizionit tonë për shtetin. Kujdesi për rininë është garanci për ndërtimin e një shoqërie të sigurt dhe me rritje ekonomike. Frymëzues bashkëbisedimi i sotëm me rininë e mrekullueshme të Gjakovës. Rinia jonë është forcë transformuese e shoqërisë dhe i përket një bote që po ndryshon me shpejtësi", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se epoka e ndërlidhjes digjitalizuese dhe teknologjisë së avancuar informative, kërkon edukim në përputhje me trendet bashkëkohore dhe përshtatje të



programeve studimore ekonomisë së vendit. "Në vizionin tonë 100 për qind Kosovë e kemi përfshirë mësimin dual, fondin

për punësim, kompensimin e 50 për qind të pagës për çdo punësim fillestar në prodhim dhe një varg masash reformuese që

garantojnë punë dhe perspektivë për rininë, për ta ndërtuar jetën dhe karrierën në vend", ka thënë Haradinaj.

### AAK-PSD premtojnë shkollim të lartë falas dhe rritje të buxhetit për arsim për 50

Zyrtarë të koalicionit AAK-PSD të dielën në një konferencë për medie kanë prezantuar platformën e këtij koalicioni lidhur me përmirësimin e gjendjes së arsimit në qeverinë e re të vendit pas zgjedhjeve të 6 tetorit. "Kjo do të bëhet nëpërmjet rritjes së kriterit për pranimin në Fakultetin e Edukimit. Do ta mbështesim autonominë e institucioneve që merren me cilësinë e arsimit në Kosovë. Kontrolli do të jetë i shtuar në universitete për plagjiaturë", ka thënë kandidati për deputet nga ky koalicion, Driton Çausi. Ndërsa kandidatja për deputet nga ky koalicion, Teuta Haxhiu, ka thënë se ka një strategji të hollësishme për ndërhyrje edhe në sistemin e arsimit parauniversitar.

# Veseli: Me mua kryeministër, bashkatdhetarët nuk do t'i paguajnë polisat e sigurimeve kur vijnë në Kosovë

PRISHTINË, 29 SHTATOR (ER) - Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryeministër, Kadri Veseli, ka qëndruar të dielën në pikën kufitare në Merdar. Aty Veseli ka takuar një bashkatdhetar i cili po hynte në Kosovë. Veseli ia ka shpjeguar atij pjesën e programit të PDK-së për mbulimin e të gjitha shpenzimeve të polisave të sigurimeve për bashkatdhetarët kur të vijnë në Kosovë. "Diaspora më së shumti ka kontribuar bashkërisht për ta mbajtur Kosovën në vitet më të rënda. Unë dëshiroj ta them këtë përmes jush që patëm fatin të takohemi. Për çdo bashkatdhetar e kemi ulur 50 përqind pagesën për polisat e sigurimeve, por tash në qeverisjen e

ardhshme do ta largojmë gjithë pagesën. Faleminderit shumë edhe nga doganierët për punën e tyre", ka thënë Veseli.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) të dielën ka mbajtur një tubim elektoral në Komunën e Lipjanit. Kryetari i PDK-së dhe kandidati për kryeministër, Kadri Veseli, ka thënë se zgjedhjet e 6 tetorit do të jenë referendum për republikën e Kosovës. Ai ka thënë se duhet të jenë bashkë që mos ta lejojnë Kosovën që të kthehet mbrapa. Veseli ka thënë se qytetarët e Kosovës duhet të vendosin në mes të një qeverie e cila është në partneritet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe një qeverie e cila do ta izolojë Kosovën.



Më tutje, Veseli ka premtuar se do ta përkrahë rininë. Veseli ka thënë se platforma e tij kundër korrupsionit është në përputhje me interesat e Kosovës dhe partneritetin me Amerikën. Veseli ka premtuar se do t'i përkrahë familjet e dëshmorëve, veteranët e UÇK-së dhe të gjitha kategoritë të cilat kanë nevojë për ndihmë. Ai i ka ftuar qytetarët e

Lipjanit dhe të gjithë Kosovës që ta votojnë numrin 112. Veseli në takim me banorët e Zhilivodës së Vushtrrisë dhe Bardhit të Fushë-Kosovës ka thënë se kudo po sheh optimizëm dhe shpresë me Partinë Demokratike të Kosovës. "Ne marrim përgjegjësi. Ne ofrojmë zgjidhje. Në qeverisjen time nuk do të ketë më të rinj që ikin

masivisht nga Kosova, por do t'u ofrojmë mundësi që të punojnë, të krijojnë familje dhe t'i rrisin fëmijët këtu, pranë baballarëve dhe gjyshërve të tyre. Në qeverisjen time do ta forcojmë edhe më shumë rolin e grave dhe do ta rrisim përkujdesjen për të moshuarit, duke ua rritur për 80 përqind edhe pensionet", ka thënë Veseli.

## Kurti: Trendi i ikjes do të ndalet përmes shtetit solidar dhe shtetit social

PRISHTINË, 29 SHTATOR (ER) - Kandidati për kryeministër i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, para qytetarëve të Therandës ka premtuar të dielën se në qeverisjen e tij do të ndalet trendi i ikjes së qytetarëve përmes shtetit solidar dhe shtetit social. Ai ka bërë me dije se do të ofrojë punësim të garantuar për një anëtar të familjes për çdo familje në skemë sociale. "Me qeverinë e re të rinjtë nuk do ta lidhin më besën me partinë, por kontratën me kompaninë dhe trendi i ikjes do të ndalet përmes shtetit solidar dhe shtetit social. Ne do të ofrojmë punësim të garantuar për një anëtar të familjes për çdo familje në skemë sociale. Do ta ndajmë mirëqenien duke paguar deri në 240 euro në vit për fëmijët nën 2 vjeç, e 120 euro në vit për fëmijët nën 16 vjeç dhe do ta heqim tatimin për të ardhurat deri në 300 euro sepse askush nuk duhet të paguaj për të mbetur gjallë", ka

thënë Kurti. Ai ka thënë se Theranda duhet të ketë ujë e trotuare, parqe e sheshe publike, duke shtuar se këto do të bëhen përmes grantit të katërt për komuna në vlerë prej 600 milionë eurosh, që do ta ndajë qeveria e re. Kurti ka treguar se edukimi do të lidhet me kërkesat e tregut në mënyrë që çdo i diplomuar ta gjejë një vend pune dhe e gjithë kjo do të mbështetet edhe prej investimeve të Bankës Zhvillimore në industrinë prodhuese dhe përpunuese që do t'i zëvendësojë importet.

Kandidati i IV-së për deputet, Salih Zyba, ka thënë se ato pak prona e ndërmarrje që i mbijetuan luftës nuk i mbijetuan pasluftës së privatizimeve nga partitë që udhëheqin vendin për 20 vjet. Ai ka deklaruar se këto parti që kanë shkatërruar ekonominë, arsimin, shëndetësinë e drejtësinë po shkojnë për mos t'u kthyer më. Ndërsa doktoresha Drita



Kabashi ka folur për atdhedashurinë dhe shëndetësinë. Ajo ka deklaruar se dashuria për atdheun dhe njerëzit në Kosovë ia shtyu ndjenjën e detyrës për

t'u kthyer dhe shërbyer në vendin e saj. Sipas saj, me qeverinë e re të udhëhequr nga Kurti do të ketë sigurime shëndetësore dhe trajtim profesional dhe

njerëzor për qytetarët e vendit pa diskriminim. Lëvizja Vetëvendosje të dielën ka mbajtur tubim zgjedhor edhe në Shtërpcë, Lipjan dhe Pejë.

# Këtë vit, 20 mijë hektarë më shumë grurë

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Këtë vit sipërfaqet e mbjella me grurë pritet të jenë rreth 20 mijë hektarë më shumë se në vitin e kaluar. Krahasuar me vitet e mëhershme, sipërfaqet e mbjella me këtë kulturë bujqësore janë përgjysmuar. Nga Ministria e Bujqësisë thonë se kulturat bujqësore do të subvencionohen me një shumë rreth 25 milionë euro, por ekspertët të bujqësisë thonë se kjo fushë është lënë anash nga qeveritë e mëparshme dhe se bujqit janë demotivuar për t'u marrë me mbjellje të grurit.

Shefi i Divizionit të Prodhimtarisë Bimore dhe Ujitjes në Ministrinë e Bujqësisë, Bali Lestrani, në një prononcim për "Ekonomia Online" ka thënë se kanë marrë të gjitha masat për subvencionet e sivjetme. "Masa mbështetëse e subvencionimit është për çdo vit. Edhe këtë vit sikurse në vitin e kaluar masa mbështetëse është për të gjitha kulturat bujqësore, për

26 sektorë, me një shumë prej 25 milionë eurosh për të gjitha kulturat bujqësore", ka thënë ai. Sipas tij, këtë vit janë planifikuar të mbillen 80 mijë hektarë për kulturat lavërtare vjeshtore, ndërsa vitin e kaluar janë mbjellë vetëm 60 mijë hektarë, 20 mijë hektarë më pak sesa janë planifikuar. "Si edhe në vitet e tjera, planifikimet janë rreth 80 mijë hektarë me kultura lavërtare. Viti i kaluar ka qenë një vit kritik për fermerët në përgjithësi në Kosovë për shkak të kushteve klimatike që kanë qenë të disfavorshme për shkak të thatësisë dhe faktorëve të tjerë. Vitin e kaluar janë planifikuar të mbillen 80 mijë hektarë, por janë realizuar rreth 60 mijë. Këtë vit po shpresojmë të mbillen 80 mijë hektarë në qoftë se kushtet do të jenë më të mira", ka thënë ai.

Lestrani ka shtuar se edhe pse janë bërë të gjitha përgatitjet për mbjellje vjeshtore, mbjelljet ende nuk kanë filluar për

shkak të thatësisë. "Për mbjelljet vjeshtore ende nuk janë bërë përgatitjet e duhura meqenëse sezoni i mbjelljes së kulturave lavërtare në vjeshtë fillon me fazën e parë apo javën e parë të tetorit, por disa prej komunave që na kanë lajmëruar parapërgatitjet veç kanë filluar", thotë ai.

Por, profesori në Fakultetin e Bujqësisë, Imer Rusinovci, në një prononcim për "Ekonomia Online" thotë se trendi i sipërfaqeve kultivuese është në rënie si pasojë e demotivimit të fermerëve. "Në raport me periudhën tradicionale që kishin fermerët në Kosovë dhe në raport me sipërfaqet e mëdha kultivuese që përfshijnë te gruri ishte kulturë strategjike dominuese në krahasim me të gjitha kulturat e tjera lavërtare. Trendi i sipërfaqeve kultivuese është në rënie. Arsyet kryesore janë demotivimet e fermerëve dhe unë konsideroj se Qeveria e Kosovës bujqësinë duhet ta

ketë prioritet", tha ai. Sipas Rusinovci, nga të dhënat në terren si dhe nga Agjencia e Statistikave, viti 2018-2019 ka shënuar rënie të eksportit, ndërsa në anën tjetër ka pasur rritje të importit. "Treguesit nga Agjencia e Statistikave tregojnë për një rënie të eksportit dhe për një rritje të importit, dukuri kjo që është e padëshirueshme sepse masa stimulative, qofshin subvencionet, gjithmonë jepen me një qëllim që të shtohet bruto prodhimi vendor dhe të reduktohet importi. Unë konsideroj se ndodhemi në periudhën e plotë të muajit shtator, kohë e cila të gjithë fermerët duhet të kenë një shkallë të mobilitetit t'i parapërgatitjen sipërfaqet për mbjelljet e grurit. Është fakt që sipërfaqet e kultivuara po na bien nga viti në vit. Trendi është në rënie dhe kjo situatë është për keqardhje për të gjithë fermerët tradicionalë që i kishte Kosova dhe për të gjitha praktikat e mira kul-

tivuese që i kishim", thotë ai. Rusinovci ka shtuar se Fakulteti i Bujqësisë, Ministria e Bujqësisë dhe Instituti i Bujqësisë në Pejë të gjejnë një emërues të përbashkët në mënyrë që të barten sa më tepër mjete të reja teknologjike. "Nuk ka asnjë arsye që sot agronomi del dhe u thotë fermerëve se mbjellja dhe plehërimi janë të rëndësishme. Ne duhet të sugjerojmë kur duhet të bëhet, cili është afati optimal, sa është doza optimale e ushqimit, përkatësisht e plehërimit dhe sa është sasia optimale e farës për mbjellje dhe këto institucione kredibile botërore po i quajnë transferime të reja teknologjike me qëllim të shtimit të prodhimtarisë për njësi sipërfaqësore".

Rusinovci thotë se vetëm me një bashkëpunim të ndërsjellë mund të përmirësohet gjendja dhe të rritet eksporti i produkteve bujqësore të cilat janë traditë e jona.



## Kapen falsifikatorët e parave

PRISHTINË, 29 SHTATOR (ER) - Policia e Kosovës, konkretisht Njësia për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Gjilan, pas një pune operative profesionale në terren, ka siguruar informacione se dy persona të dyshuar meshkuj/shqiptarë/kosovarë

Q. A. (1953) dhe Sh. B. (1964), merren me falsifikim dhe shpërndarje të parave.

Hetuesit rajonalë për hetimin e krimeve ekonomike dhe korrupsionit në PK, në bashkëpunim dhe bashkërendim me prokurorinë kompetente në Gjilan,

kanë siguruar bazën ligjore për aplikimin e masave të përcaktuara me ligj dhe më 27. 09. 2019 është realizuar një operacion për kapjen e personave të dyshuar. Si rezultat i këtij operacioni policor, dy personat e dyshuar janë ndaluar në Suharekë dhe gjatë kontrol-

limit tek i dyshuari Q. A. (1953) janë gjetur dhe sekuestruar kartëmonedha (196 X 50), ose shuma e përgjithshme 9 800 euro, që dyshohet se janë të zhytura (ngjyroshura) dhe supozohet se janë para të grabitura. Si vazhdimësi e operacionit

policor janë kryer edhe bastisje në lokacionet e të dyshuarve në Prizren dhe Sallagrazhdë, përderisa me urdhër të prokurorit kompetent ndaj dy të arrestuarve është caktuar masa e ndalimit policor për 48 orë, për procedura të mëtejme.



# Premtimet e partive për rritje ekonomike bien ndesh me FMN-në



AFP

**Nga 6 deri në 9 për qind rritje ekonomike kanë premtuar partitë dhe koalicionet garuese në zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit në Kosovë. Këto premtime, sipas ekspertëve të çështjeve ekonomike, po cilësohen të paarritshme dhe po shihen vetëm si premtime elektorale**

**PRISHTINË, 29 SHTATOR** - Në Kosovë përgjatë viteve të fundit rritja ekonomike nuk ka shënuar më shumë se 4 për qind. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) ka parashikuar për vitin 2019 një rritje ekonomike për Kosovën deri 4.2 për qind, ndërsa projeksionet e FMN-së për rritjen ekonomike për vitet 2020 deri në vitin 2024 janë jo më shumë se 4 për qind. Nisur nga premtimet e bëra publike, Partia Demokratike e Kosovës në programin qeverisës ka paraparë rritje ekonomike rreth 8 për qind. Koalicioni ndërmjet Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Partisë Socialdemokrate ka premtuar rritje ekonomike nga 7 deri në 9 për qind. Koalicioni Nisma

Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë kanë premtuar rritje ekonomike më të lartë se 5 për qind. Lëvizja Vetëvendosje ka garantuar dyfishim të normës vjetore të rritjes ekonomike në Republikën e Kosovës, ndërkaq Lidhja Demokratike e Kosovës, në bazë të paraqitjeve publike, ka premtuar rritje ekonomike deri në 8 për qind. Rëndësia e rritjes ekonomike qëndron në faktin se rritja deri në 4 për qind vlerësohet se nuk adreson problemet me të cilat përballet Kosova, siç janë papunësia e varfëria, ndërsa rritja ekonomike 6 deri në 9 për qind vlerësohet se do të ndikonte në uljen e varfërisë dhe hapjen e vendeve të reja të punës, duke

ulur kështu edhe shkallën e papunësisë.

Safet Gërxhaliu, ekspert për çështje ekonomike, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se këto premtime në këtë kohë zgjedhesh nuk mund të shihen reale. "Në fushatën zgjedhore premtimet janë të pakontrolluara. Në këtë kaos ekonomik në të cilën gjendet Kosova, ku kemi vobekësi të rendit dhe ligjit, ku kemi mungesë të disiplinës financiare, si pasojë e së cilës janë prishur edhe raportet me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), kur e kemi këtë rënie të interesimit të investitorëve të huaj të investojnë në Kosovë, po ashtu kur kemi këtë trend të barrierave që gjenerohen në forma të ndryshme dhe këtë imazh që jemi duke e ndërtuar, është utopike të mendohet se do të ketë rritje ekonomike jo 6 e 9 për qind, por do të ishte e dëshirueshme që në vitin 2020 të kemi rritje ekonomike 4 për qind", ka thënë Gërxhaliu.

Që Kosova të ketë rritje ekonomike çfarë po premtohet, shton Gërxhaliu, duhet të ketë reforma substanciale në fusha të ndryshme e që, sipas tij, këto reforma vështirë se mund të bëhen me këta kandidatë të cilën synojnë qoftë ulëse në Kuvend apo në institucione. Për vite me radhë, shton Gërxhaliu, sektori

ekonomik në Kosovë është anashkaluar, gjë që ka penguar zhvillimin ekonomik në vend. "Duhet të kuptohet që nëse analizohen rekomandimet e diplomatëve dhe shteteve mike të Kosovës, ekonomia dhe aspekti social as që gjenden në agjendën e rekomandimeve në këto shtete, por esenca është marrëveshja me Serbinë dhe normalizimi i raporteve në këtë drejtim dhe po shihet që qeveria e ardhshme do të ketë shumë më tepër angazhime rreth zgjidhjes së problemeve të kaluara. Që ekonomia të jetë prioritet duhet të ketë sundim të rendit dhe ligjit dhe kur për ekonominë të flasin ekspertët dhe jo politikanët dhe meritokratët, është koha të promovohen vlerat", thotë Gërxhaliu.

Eksperti tjetër i çështjeve ekonomike, Naim Gashi, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se nëse shikohen programet qeverisëse të partive politike në garë për zgjedhjet e 6 tetorit, nuk mund të arrijnë rritje ekonomike deri në 9 për qind ashtu siç pretendojnë. "Nëse i marrim parasysh premtimet e tyre elektorale se do t'i forcojnë skemat sociale dhe përfutimet në paga dhe mëditje nga sektori publik, atëherë duhet të tregojmë se kjo është kontradiktore për faktin se rritja e pagave në sektorin publik

dhe destinimi i mjeteve vetëm për sektorin publik e frenon sektorin privat, i cili është bartës i zhvillimit ekonomik të çdo vendi", ka thënë Gashi.

Gashi ka shtuar se ekziston mundësia e rritjes ekonomike edhe më tepër se 4 për qind sa ka qenë përafërsisht në vitet e fundit, por nevojiten masa konkrete që duhet të ndërmerren në ekonomi. "Do të ishte më mirë që të premtonte që në vitin e parë do ta nxisin ekonominë që të rritet për 1 për qind dhe, ndoshta, do të ishte reale që në katër vjetët e qeverisjes të rritet nga 1 për qind. Po ashtu, do të ishte reale që partitë politike t'i tregojnë masat konkrete nga vjen ajo rritje", është shprehur Gashi.

Për të pasur një nivel më të lartë të rritjes ekonomike, ekspertët thonë se duhet të përkrahët sektori privat, politika të favorshme fiskale, të ketë konkurrencë të barabartë në treg, të ashpërsohet lufta kundër evazionit fiskal dhe të bëhen reforma të tjera.

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë do të mbahen më 6 tetor. Nga procesi i votimit pritet të zgjidhet përbërja e re e Kuvendit të Kosovës, nga e cila më pas partia apo koalicioni fitues do ta marrë mandatin për formimin e Qeverisë së ardhshme të Kosovës për një mandat kushtetues katërvjeçar.

## Kontradiktat e punimeve në Kalanë e Novobërdës

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Askush nuk mund ta vizitojë nga afër Kalanë e Novobërdës. Afër saj janë vendosur shiritat që tregojnë për rrezikun nga shembja e gurëve. Shiritat u vendosën pas ndaljes së punimeve në konservimin e kalasë, që po kryhen nga kompania "Koto" nga Beogradi. Vendimin për ndaljen e punimeve e mori Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve pasi para pak ditësh u shembën disa pjesë të mureve të jashtme të kalasë.

Drejtori i këtij instituti, Ismet Hajrullahu, thotë se puna e kompanisë nga Beogradi, që e fitoi projektin ndërkombëtar të shpallur nga UNESCO, vazhdimisht është përcjellë me skandale. "Punë joprofesionale, të cilat i kanë shoqëruar skandale të njëpasnjëshme, me betonimin e gjetjeve arkeologjike të Kosovës, gjë që është vepër penale, është vepër e dënueshme deri te përdorimi i ekskavatorit që ishte herën e fundit, që preken muret me ekskavator, gjë që është krejtësisht e paparë diku, që në një aset të trashëgimisë kulturore siç është, p. sh., Kalaja e Novobërdës, të preken muret me ekskavator. Në vendet e

ndryshme edhe makineritë që janë me tonazh të lartë nuk iu afrohen aseteve të trashëgimisë kulturore për shkak të vibracioneve që mund t'i japë makineria e lartë, e lërë më pastaj prekja e mureve me ekskavator", ka thënë Hajrullahu.

Projekti për rivitalizimin dhe ruajtjen e Kalasë së Novobërdës ka filluar në vitin 2014 dhe ka për qëllim ruajtjen e kalasë, por edhe nxitjen e turizmit në këtë pjesë.

Pas ngritjes së shqetësimeve nga institucionet kosovare për punët që po kryhen në Kalanë e Novobërdës, në UNESCO thonë se çdo ndërhyrje është bërë në bashkëpunim të ngushtë me institucionet përgjegjëse të Kosovës. "UNESCO po ndjek me vëmendje zhvillimin e situatës dhe ka elaboruar tashmë masat e kërkuara të ruajtjes, për ta ndaluar prishjen e mëtejshme të strukturës. Të gjitha ndërhyrjet e implementuara deri më tani janë bërë në bashkëpunim të ngushtë me institucionet përgjegjëse lokale", thuhet në përgjigjen e UNESCO-s për "Radion Evropa e Lirë". Edhe institucionet e Kosovës janë të ndara për faktin se si po kryhen punimet në këtë kala.



Mendim shumë më pozitiv për punën që ka kryer UNESCO dhe kompania "Koto" në Kalanë e Novobërdës, ka thënë drejtori i Institutit Arkeologjik të Kosovës, Enver Rexha. "Ne nuk e kemi zgjedhur kompaninë, e ka zgjedhur UNESCO-ja. Ne e kemi obligim profesional t'i trajtojmë për detyrën që duhet ta kryejnë dhe detyra e tyre, deri më 2018, ka qenë e mirë. Mirëpo, dëmi ka dalë dhe duhet të shqyrtohet si dëm dhe duhet të rregullohet, të ecet tutje. Unë mendoj se UNESCO-ja do ta rregullojë këtë çështje, pavarësisht prej mendimeve tona, a jemi pro a

kundër apo kemi kërkesa që të largohet kjo kompani apo tjetra. Unë besoj se do ta marrin sinqerisht, siç janë sinqerisht duke punuar", ka theksuar Rexha. Arkeologët, të cilët më parë kanë bërë kërkime arkeologjike në Novobërdë, thonë se projekti duhet të vazhdojë pavarësisht prej dëmeve që janë shkaktuar. Arkeologu Haxhi Mehmetaj, tani në pension, kërkon që të mos politizohet rasti i Kalasë së Novobërdës. "Nuk duhet të përdoret Artana, qyteti mesjetar për politikë, për të bërë politikë, por duhet të gjykohej esëll dhe të shi-

het domethënë se si mund të vazhdohet, se si mund përsëri të krijohen raporte të mira me UNESCO-n, në mënyrë që ajo ta përdorë autoritetin, në mënyrë që ajo t'i përdorë firmat. Të njëjtat firma duhet ta mbajnë barrën e përgjegjësisë dhe ta vazhdojnë projektin, por tash, me një mbikëqyrje tjetër, domethënë me një mbikëqyrje permanente edhe nga institucionet vendore dhe nga institucionet ndërkombëtare", ka vlerësuar Mehmetaj. Paratë për rivitalizimin e Kalasë së Novobërdës i ka dhënë Bashkimi Evropian.

## Ahmeti prezanton projektet e Prishtinës për vitin 2020

PRISHTINË, 29 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, në konferencë për medie ka paraqitur projektet që janë pjesë e buxhetit për vitin 2020, i cili është miratuar në mbledhjen e fundit të Kuvendit Komunal të Prishtinës. Ai ka thënë se është hera e parë që nga viti 2014 që buxheti i Komunës së Prishtinës të miratohet unanimisht me asnjë votë kundër dhe me përkrahje nga të gjitha subjektet politike që janë pjesë e Kuvendit Komunal të Prishtinës. "Këtë vit Prishtina për herë të parë ka një buxhet prej 91 milionë eurove, që është rezultat i kalimit të Ligjit për kryeqytetin dhe është buxhet që do të ndikojë në përmirësimin e jetës së qytetarëve në pjesën urbane dhe rurale të krye-



qytetit. Kjo në të njëjtën kohë e bën Komunën e Prishtinës një prej organizatave më të mëdha buxhetore dhe mundëson realizimin e disa projekteve të mëdha infrastrukturore të planifikuara", ka thënë Ahmeti.

Ai ka bërë me dije se ruga "Isa Kastrati", që lidh Prishtinën me "Mati 1", do të rindërtohet në tërësi. "Projekti i tunelit në përfundim të rrugës 'Agim Ramadani' do ta mundësojë vazhdimin e Sheshit 'Ibrahim Rugova' dhe ta bëjë lid-

hjen me pjesën e vjetër të qytetit, duke e zgjeruar pjesën pedonale të qytetit. Në atë pjesë do të realizohet edhe projekti i tregut të gjelbër dhe restaurimi i fasadave të shtëpive dhe objekteve, pjesë e trashëgimisë kulturore e që do të ndihmojë revitalizimin dhe integrimin e kësaj pjesë të qytetit", ka deklaruar Ahmeti. Ai ka thënë se në fund të vjeshtës do të fillojë ndërtimi i parkingut nëntokësor me 700 vendpikime dhe, sipas tij, me këtë rast Bulevardi "Xhorxh Bush" do të mbyllet për trafik, përveç një korsi për autobusë, siç e parasheh Plani i qëndrueshëm i mobilitetit. "Buxheti parashesh edhe investimin në Pallatin e Rinisë për tri institucione të rëndësishme për rininë e kryeqytetit. Shkolla e muzikës 'Prek Jakova', 'Bonevet'

dhe projekti i përbashkët me Fondacionin 'Sunny Hill' do të funksionojnë në aneksin e Pallatit, hapësirat ku ka qenë Shkolla Amerikane. Në buxhet janë të ndara 1.5 milion euro për sallën koncertale në Prishtinë dhe për këtë projekt janë duke u zhvilluar konsultimet e fundit me Komisionin Evropian dhe komunitetin e arkitektëve dhe artistëve. "Unaza e qytetit është, mbase, projekti më i madh infrastrukturor me një kosto mbi 100 milionë euro dhe për këtë është siguruar financimi nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Momentalisht në procedura tenderuese është konsulencia e cila deri në qershor të 2020-s do ta përgatisë dizajnin përfundimtar të kësaj unaze", është shprehur Ahmeti.

## Kuvendi i Komunal i Malishevës miraton buxhetin për vitin 2020

MALISHEVË, 29 SHTATOR (ER) - Kuvendi i Komunës së Malishevës ka miratuar me plotësim dhe ndryshime projektbuxhetin komunal të propozuar nga kryetari i kësaj komune, Ragip Begaj. Projektbuxheti komunal për vitin 2020-2022, me theks të veçantë për vitin 2020, ka kaluar në disa procese të shqyrtimit dhe

diskutimeve publike, ku fillimisht qeveria komunale, i ka mbajtur dëgjimet publike me qytetarë dhe e ka dërguar në Kuvendin e Komunës për shqyrtim.

Kuvendi Komunal i Malishevës më pas e ka dërguar në diskutim publik dhe debatet i ka organizuar kuvendi. Pas kalimit në të gjitha këto procedura të hartimit

të buxhetit, ai sot është miratuar me shumicë të votave nga ana e anëtarëve të kuvendit të komunës. Buxheti i Komunës së Malishevës për vitin 2020 është 15 milionë e 583 mijë e 802 euro dhe është i ndarë në pesë kategori buxhetore. Për investime kapitale janë të ndara 3 milionë e 840 mijë e 909 euro.



# Diplomacia, e sëmura e Ballkanit

(Fragment nga libri i autorit "Ballkani, diplomacia e munguar")



Prof. Lisen BASHKURTI

Roli i diplomacisë gjatë Luftës së Parë Botërore ishte mjaft kontrovers.

Diplomacia joushtarake dhe propaganda e luftës vepruan interaktivisht së bashku ndërmjet kombeve me qëllim që t'i mbështesnin kauzat e luftës, ose ta minonin mbështetjen e armiqve të tyre. (Norman Rich, Great Power Diplomacy: Since 1914 (2002) pp. 12-20; Strachan, The First World War: Volume I To Arms (2001) pp. 974-75).

Në pjesën më të madhe të saj diplomacia e Luftës së Parë Botërore u përqendrua në pesë çështje themelore: së pari, në fushatat propoandistike; së dyti, në përcaktimin dhe ripërcaktimin e qëllimeve të luftës, të cilat bëheshin përherë e më të ashpra me vazhdimin e luftës; së treti, në përpjekje të ndryshme për kombet neutrale (Itali, Perandori Osmane, Bullgari dhe Rumani) që t'i fuste në koalicion politik-ushtarake, duke u ofruar pjesë nga territoret e shteteve armike; së katërti, në inkurajimin e lëvizjeve të minoriteteve kombëtare brenda fuqive qendrore, sidomos midis çekëve, polakëve dhe arabëve; së fundi, në bërjen e shumë propozimeve për paqe nga vendet neutrale, ose nga njëra apo tjera palë në luftë. Por, faktikisht, asnjëri prej tyre nuk pati sukses të shpejtë e të dukshëm. Ato mbetën propoz-

ime në bisedime ose drafte në letër (29 J.A.S. Grenville, ed., The Major International Treaties of the Twentieth Century: A History and Guide with Texts, Vol. 1 (Taylor & Francis, 2001) p. 61.).

Kjo traditë dështimi vijoi deri në fund të Luftës së Dytë Botërore. Mbas kësaj lufte, diplomacia evropiane bëri një kthesë të plotë. Diplomacia evropiane e mbas dy luftërave kuptoi thelbin e misionit të saj, jo si makineri lufte dhe as si propagandë lufte, por si instrument i paqes, i demokracisë dhe prosperitetit në marrëdhëniet ndërkombëtare. Gjithë projekti evropian kishte si bazë teorinë e paqes demokratike, në të cilën diplomacia luan rolin kryesorë (Gleditsch, Nils P. (1992). "Democracy and Peace". Journal of Peace Research. 29 (4): 369-376).

Një transformim i tillë i diplomacisë nuk ndodhi në Ballkanin e pas dy luftërave, madje nuk ndodhi as mbas rënies së Murit të Berlinit (1989). Mësime të mëdha historike nga Lufta e Parë dhe e Dytë, por edhe mbas rënies së Murit të Berlinit dalin për Ballkanin.

Ky nënrajon i vogël u bë shkak për nxitjen e fillimit të Luftës së Madhe. Një atentat në Sarajevë solli vdekjen e dy personave, që u pasua me tragjedinë e miliona njerëzve nëpër botë. Një plumb që vrau miliona! Gjithashtu, ky nënrajon u bë shesh betejash ideologjike midis komunizmit, fashizmit dhe demokracisë liberale midis dy luftërave. Ndërsa në Luftën e Dytë Botërore u bë arenë e një përgjakje sa ndërkombëtare aq edhe civile.

Ajo që nuk ndodhi në diplo-

macinë ballkanike pas luftërave botërore, pritej të ndodhte mbas rënies së Murit të Berlinit dhe përfundimit të Luftës së Ftohtë, së paku në nivel evropian. Por, sërish në Ballkan, diplomacia vijoi të mbetej prapa. Politikat nacionaliste, rivalitetet shtetërore, dhunimi i pakicave etnike, shkelja e të drejtave të njeriut, injorimi i të drejtës ndërkombëtare, lider-shipet egoistike, administratat e dobëta, orientimet gjeopolitike kontroverze, armiqësitë fqinjësore, mungesa e bashkëpunimit rajonal, diplomacia e munguar - e shndërruan Ballkanin në 'Fuqi Baroti'. (Tom Gallagher, The Balkans after the Cold War-From Tyranny to Tragedy, New York, Routledge, 2003).

Nëse Evropa nxori mësime nga dy luftërat botërore dhe ndërmori ndryshime madhore për t'u dhënë fund luftërave dhe nxitjen e paqes së qëndrueshme, demokracisë dhe prosperitetit ekonomik, Ballkani vuan akoma nga sindromat negative të trashëguara nga historia. Në Ballkan e kaluara akoma nuk është futur në arkiv si pjesë e historisë, por është gjallë dhe ndikon mbi politikën dhe diplomacinë.

Ballkani sërish vuan nga recidivat e doktrinave nacionaliste, nga rivalitetet shtetërore, nga mosnjohja ose mosrespektimi i të drejtave të njeriut dhe pakicave etnike. Ballkani, ndonëse ka firmosur një sërë marrëveshjesh ndërkombëtare për t'u dhënë fund luftërave dhe për ta ndërtuar paqen, sërish i shkel marrëveshjet ndërkombëtare që vetë i firmos.

Në krye të të gjithave Ballkani vuan për leadership dhe qeverisje të mirë. Leadership Ballkanik

preferon më shumë ta ndjekë sjelljen e trashëguar nga modellet e vjetra sesa modelin bashkëkohor të leadershipit evropian. Por, edhe kur leadershipi ballkanik hedhur ndonjë hap përpara, është administratë publike që nuk iu përgjigjet ndryshimeve, duke iu bërë rezistencë dinamikave të reja ballkanike.

Ballkani është akoma 'pa dyer' në orientimet e veta gjeopolitike. Ndonëse gjithë vendet e Ballkanit deklarohen për orientim evropian dhe më së shumti edhe për orientim euroatlantik, kur vjen puna në mendimet, qëndrimet, veprimet e sjelljet konkrete, ato vijnë të jenë konfuze, duke krijuar hapësira për depërtime të pranishme dhe influencës jashtë gjeopolitikës euroatlantike. Kjo e vë Ballkanin në situatë mjaft dilematike dhe paqartësie për të ardhmen.

Ballkani është periferia e Kontinentit Evropian ku vazhdojnë të ekzistojnë një mal problemesh midis fqinjëve. Disa probleme janë të trashëguara nga historia, disa të lindura mbas Luftës së Ftohtë dhe, së fundi, disa të krijuara gjatë tranzicionit. Vendet e Ballkanit në shumë raste nuk i shohin realitetet në sy, nuk i pranojnë ndryshimet në mjedisin politik dhe sillen jashtë realiteteve, duke krijuar tensione, probleme dhe kriza të herëpashershme fqinjësore.

Gjithë shtetet e Ballkanit kanë nevojë emergjente t'i respektojnë dhe t'i ndjekin rigorozisht linjat e politikës evropiane të fqinjësisë së mirë dhe të heqin dorë nga modele të tjera, që mbajnë kriza të ngrira me fqinjët dhe që përdorin pakicat etnike për interesa egoiste gjeopolitike.

Ballkani vijon të jetë ndërkom-bëtarisht i perceptuar si inerci i 'Fuqisë së barotit'. Rajoni, ndonëse i vogël, vijon të jetë i fragmentuar. Nuk ka vizione të qarta dhe të qëndrueshme, politika të përbashkëta, projekte zhvillimore në kontekst mbarëballkanik. Mungon dukshëm kohezioni ekonomik, social dhe territorial në nivel Ballkani. Qeveritë e vendeve ballkanike i bashkon vetëm retorika evropiane, por kur vjen puna të politikëbërjet dhe veprimet konkrete, egoizmat mëndje-lokale të mbyllura dominojnë mbi mendjet e hapura integruese dhe globalizuese.

Dhe, e fundit, por jo nga rëndësia, Ballkani është nënrajon i diplomacisë së munguar. Në trashëgiminë, por mjerisht edhe në të sotmen e Ballkanit, diplomacia është pika më e dobët. Kultura e bisedimeve, e mbajtjes gjallë të dialogut të hapur, e krijimit të klimës së përhershme të negociatave dhe e zgjidhjes se çdo problemi me rrugë dhe mjete diplomatike, pra me frymë konsensusi ose kompromisi, janë ende larg realiteteve ballkanike.

Në Ballkan diplomacia është e nënvlerësuar, diplomatët janë të nëpërkëmbur, konsensusi është i mohuar, kompromisi është i përçmuar dhe, për pasojë, i turpshëm, ose i konsideruar tradhti. Një rajon që ka këtë nënvlerësim të diplomacisë, këtë përçmim të diplomatëve dhe këtë konsideratë negative për mjetet dhe rrugët diplomatike për zgjidhjen e krizave, ka dhe do të ketë pengesa serioze për të arritur një paqe të qëndrueshme, demokraci dhe prosperitet social-ekonomik për mbarë popujt e Ballkanit.

## Gjendet trupi i pajetë i qytetares së zhdukur nga Mushnikova e Prizrenit

PRIZREN, 29 SHTATOR (ER) - Ministria e Mbrojtjes ka bërë me dije se Kompania e Kërkim-Shpëtimit e Gardës Kombëtare të Kosovës ka gjetur trupin e pajetë të qytetares së zhdukur nga Mushnikova e Prizrenit. Sipas kësaj ministrie, ajo ishte zhdukur më 26 shtator. "Të dielën rreth orës 14:00 togu për kërkim në male, i kompanisë së

kërkim-shpëtimit i Regjimentit të Mbrojtjes Civile të Gardës Kombëtare (FSK), së bashku me Policinë e Kosovës dhe banorët lokalë, gjetën trupin e pajetë të qytetares B. Gj. nga fshati Mushnikovë i Prizrenit, e moshës 69-vjeçare, e deklaruar e zhdukur që nga data 26. 09. 2019", është thënë në njoftimin e Ministrisë së Mbrojtjes.



## Johnson: Brexiti do të ndodhë më 31 tetor

LONDËR, 29 SHTATOR - Boris Johnson u zotua se do të vazhdojë të jetë kryeministër i Britanisë së Madhe edhe nëse dështon që të arrijë një marrëveshje me Bashkimin Evropian, duke shtuar se vetëm qeveria e tij konservatore mund ta respektojë datën 31 tetor, që është afati i fundit që vendi të largohet nga BE-ja.

Johnsoni dëshiron që Britania të largohet nga BE-ja me ose pa marrëveshje. Por, Parlamenti britanik ka miratuar një ligj, që kërkon nga kryeministri që Brexiti (dalja e Britanisë nga BE-ja) të shtyhet nëse ai nuk siguron

një marrëveshje me Brukselin në samitin e BE-së që do të mbahet më 17 dhe 18 tetor. Megjithatë, Johnsoni, gjatë një interviste për BBC, nuk shpjegoi se si planifikon që ta anashkalojë këtë ligj, të cilin ai e quan "akti i dorëzimit". "Njerëzit e ndiejnë se ky shtet po i afrohet një momenti të rëndësishëm dhe ne duhet ta finalizojmë Brexitin më 31 tetor. Unë do ta bëj këtë", tha Johnsoni.

I pyetur se a do të jepte dorëheqje nga pozita e kryeministrit nëse nuk arrin të sigurojë një marrëveshje të re, Johnsoni tha: "Jo, unë kam marrë udhëheqjen

e partisë dhe të vendit tim në një kohë të vështirë dhe do të vazhdoj ta bëj një gjë të tillë. Besoj se kjo është përgjegjësia ime".

Kryeministri britanik, megjithatë, tha se ende është optimist se mund të arrijë "një marrëveshje të mirë" me Brukselin, por shtoi se ai nuk do të pretendojë se arritja e kësaj marrëveshjeje është një gjë e lehtë. "Është e vërtetë që shtetet e tjera të BE-së gjithashtu nuk duan që kjo punë të zvarritet. Ekziston një pikëpamje e fuqishme në BE se është koha për të lëvizur përpara", tha Johnsoni.



# Debat i ashpër në ShBA për procesin hetimor ndaj presidentit Trump

Presidenti Trump e denoncoi procesin si mashtrimi më i madh në historinë e politikës amerikane, kurse kryetarja demokrate e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, konfirmoi se hetimi do të vazhdojë pavarësisht rrezikut politik që po ndërmarrin demokratët



UASHINGTON, 29 SHTATOR - Në Shtetet e Bashkuara vazhdon debati për fillimin e hetimeve në Kongres me qëllim shkarkimin e presidentit Donald Trump, i cili e denoncoi procesin nëpërmjet një mesazhi videofonik në "Twitter", si "mashtrimi më i madh në historinë e politikës amerikane". Nga ana tjetër, kryetarja demokrate e Dhomës së Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, konfirmoi se hetimi do të vazhdojë pavarësisht rrezikut politik që po ndërmarrin demokratët. "Ajo që po ndodh është mashtrimi më i madh në historinë e politikës amerikane", deklaroi presidenti Trump. Nëpërmjet një videoje në

"Twitter" të filmuar në kopshtin e trëndafilave të Shtëpisë së Bardhë, presidenti Donald Trump sulmoi demokratët. "Rrezikohet si kurrë më parë vendi ynë. Është e gjitha shumë e thjeshtë. Po mundohen të më ndalin pasi unë po luftoj për ju. Nuk do ta lejoj kurrë që të ndodhë kjo gjë", tha presidenti Trump, ka njoftuar voa.

Po kështu, avokati personal i presidentit, Rudy Giuliani, i doli në mbrojtje presidentit Trump gjatë një interviste në kanalën "Fox News", duke vënë në

pikëpyetje vendimin e demokratëve për t'i filluar hetimet me qëllim shkarkimin e presidentit. Giuliani tha se edhe sikur gjatë telefonatës presidenti Trump dhe presidenti ukrainas Zelensky t'i kishin thënë vetëm mirëmengjesi njëri-tjetrit, sërish demokratët do të kishin thënë se aty pati një mesazh të fshehur.

Demokratët, ndërkaq, e paraqesin krejt ndryshe procedurën hetimore për shkarkimin e presidentit. "Njerëzit thonë se po ndërmarrim një rrezik poli-

tik, por kjo nuk ka ndonjë rëndësi. Nuk mund të lejojmë që presidenti ta shkelë betimin e bërë kur mori detyrën", tha Pelosi.

Kreu i demokratëve në Senat, Chuck Schumer, mbështeti gjithashtu nisjen e hetimeve.

"Donald Trump, mos ki asnjë dyshim. Nëse faktet qëndrojnë, Nancy Pelosi dhe Chuck Schumer do të qepen nga pas", tha Schumer.

Disa shpresojnë se ky proces të përmbyllet përpara zgjedhjeve paraprake të 2020-s, duke

paraqitur akuzat në Dhomën e Përfaqësuesve përpara Krishtlindjes. Megjithëse Kongresi është zyrtarisht në një periudhë pushimi dyjavësh, Komisioni i Zbulimit i Dhomës së Përfaqësuesve do të ketë të premtën një seancë dëgjimore me Inspektorin e Përgjithshëm, i cili e pati paraqitur denoncimin e informatorit si një çështje "urgjente shqetësuese".

Megjithatë, kandidatët demokrate për president nuk duket se dëshirojnë t'u kushtojnë hetimeve shumë vëmendje. "Kemi shumë gjëra për të folur dhe për hetimet unë jam shprehur më parë", u tha gazetarëve Elizabeth Warren, kandidatja demokrate për president.

Kandidatët mendojnë se hetimet ndaj presidentit po lënë në hije çështjet e tjera të cilat ata fokusohen. "Nëse fle në motel dhe as atë nuk e përballon dot më financiarisht, a do të kishe kohë për ta ndjekur skandalin e Ukrainës? Dyshoj shumë", thotë kandidati demokrat Pete Buttigieg. "Fokusi im sot dhe përgjithmonë do të jetë te çështjet që i lënë njerëzit pa gjumë dhe që duan zgjidhje", u tha gazetarëve kandidatja demokrate Kamala Harris.

## Kurzi, fitues i zgjedhjeve në Austri

VJENË, 29 SHTATOR - Anketat tregojnë se Partia e kancelarit Sebastian Kurz ka fituar bindshëm zgjedhjet e parakohshme të së dielës në Austri.

Sipas tyre, Partia Popullore e Kurtzit ka marrë 37.2 për qind, larg Socialdemokratëve që kanë 22 për qind, e Partisë së Lirisë me 16 për qind. Të Gjellbrit kanë marrë 14.3 për qind, ndërsa liberalët e Neos kanë marrë 7.4 për qind.

Austriakët votuan të dielën në zgjedhjet e parakohshme parla-

mentare si rezultat i një video-skandali që rrëzoi nga pushteti koalicionin qeveritar të konservatorit Sebastian Kurtz dhe Partisë së Lirisë të ekstremit të djathtë.

Koalicioni qeveritar i Kurtzit u rrëzua pasi një video e publikuar tregonte zëvendëskancelarin e tij dhe udhëheqësin e Partisë së Lirisë, Heinz-Christian Strache, gjatë një darke në Ibiza me një grua e cila pozonte si mbesa e një oligarku rus. Në video Strache shihet teksa ofron për t'i

ndërmjetësuar kontratat qeveritare. "Shpresoj të ketë një koalicion më të mirë pas zgjedhjeve. Asnjë koalicion i ri nuk është i pamundur. Kurtz do të donte të qeveriste i vetëm, por nuk do të jetë në gjendje ta bëjë këtë", thotë një votues austriak. Pas skandalit mbështetja për Partinë e Lirisë ka rënë. "Fakti që duhet të votoj përsëri nuk më zemëron. Ajo që më zemëroi ishte përmbajtja e video-regjistrimit", thotë një tjetër votues në Austri.





# ME ALI AHMETIN AFËR PORTRETIT TË ABEJES

**Ismet SYLEJMANI**

Në selinë e BDI-së në foto me Udhëheqësin e popullit shqiptar, shokun e mikun tim Ali Ahmeti!

Në hollin e selisë së BDI-së në Tetovë është një pamje madhështore!

Portrete e piktura të figurave më të mëdha të luftës për liri e çlirim të popullit shqiptar!

Nuk është e mundur që mos të të shkojnë mornica trupit, sepse aty të del përballë një histori e tërë çlirimtare e popullit shqiptar të Kosovës dhe Viseve të saja nën ish-Jugosllavi!

Në këtë holl gjigant për nga pamja por jo edhe për nga madhësia, sepse nuk ngjanë me hollet me mure të ftohta të ndërtesave të larta, por të një shtëpie tetovare, të dalin njëri pas tjetrit portretet e udhëhe-

qësve dhe ideologëve të çështjes kombëtare, të luftëtarëve e komandantëve të UÇK-së!

Afër e në një rresht me të mëdhenjtë e luftës së armatosur çlirimtare të çlirimit të pjesëve të pushtuara të kombit, është edhe luftëtari i përmasave ndërkombëtare, luftëtari e heroi i Kroacisë, biri i lavdishëm i shqiptarizmes, i madhi dhe i pavdekshmi, Heroi i Kombit Bekim Berisha – ABEJA!

Në Tetovë, në shtëpinë e famshme politike e kombëtare, partiake e shtetërore në Maqedoninë e Veriut, të Udhëheqësit të popullit shqiptar Ali Ahmeti, Abeja i madh e i lavdishëm zë vend nderi e respekti!

Lavdi e përjetshme Heroit të Kombit Bekim Berisha!

Nderim e respekt Udhëheqësit të popullit shqiptar Ali Ahmeti!

**Prishtinë, 29 Shtator 2019!**



E rrallë

## Hoteli i frikshëm hap dyert për vizitorët

Një hotel i pazakontë është inauguruar para dy ditësh në Tenezi, ShBA. Ndërtesa e restauruar mban një histori të frikshme në themelet e saj pasi në vitin 1920 është vrrarë një vajzë nga i dashuri i saj. Nga historitë e trashëguara shumica e njerëzve tregojnë se shpirti i saj ende përndjek ambientet e ndërtesës.



Pikërisht dhoma ku ndodhi ngjarja ka marrë emrin e viktimës Annalisa Nethrly ose, siç njihet ndryshe, dhoma 311 është restauruar sipas modelit të vitit 1920.

### FOTO E DITES



Një djalë afgan bartë me gomar karrige për t'i dërguar në qendrat e votimit në provincën Panjshir, Afganistan. /REUTERS/

### E jashtëzakonshme

## Zjarrfikësit që u bënë përnjëherësh baballarë

Në mes të marsit dhe korrikut, nëntë zjarrfikës të një njësie në Rancho Cucamonga Fire District në Kaliforni u bënë baballarë përnjëherësh. Të gjitha bashkëshortet e tyre

kishin ngelur shtatzëna pothuajse në një kohë. Ndjesinë e prindit ata e kanë treguar me një foto kur të gjithë së bashku



mbajnë në krah foshnjat e tyre disamuajshe.




#### DASHI

Disa komunikime të papritura, por të mirëpritura mund të vijnë në rrugën tuaj, ndoshta nga partneri/partnerja ose një mik i ngushtë.



#### DEMI

Eksperimentet që kombinojnë kreativitetin dhe teknologjinë mund t'ju sjellin disa mundësi të reja.



#### BINJAKËT

Sot mund të tërhiqeni nga format e artit të pazakonta.



#### GAFORRJA

Një mik i vjetër, me të cilin nuk jeni takuar prej kohësh, mund t'ju vizitojë sot.



#### LUANI

Një ftesë e papritur nga një mik mund t'ju dërgojë në një udhëtim të shkurtër, ndoshta për të takuar këtë person.



#### VI RGJËR ESHA

Mundësitë e reja në karrierë do të rikthejnë sërish në vëmendje ambicien tuaj.



#### PESHORJA

Sot mund ta planifikoni udhëtimin në një vend, në të cilin mund të mos keni qenë kurrë.



#### AKREPI

Vizita nga një mik/mikeshë, të cilin s'e keni takuar prej kohësh, mund t'ju sjellë ndërmend kujtime të paharrueshme.



#### SHIGJETARI

Sot mund të bini në dashuri me shikim të parë. Kjo mund të jetë edhe dashuria juaj e parë.



#### BRICJAPI

Zhvillimet e reja ju bëjnë që të rriten rrahjet e zemrës për karrierën tuaj.



#### UJORI

Interesat për artin nga vendet e largëta mund ta tërheqin vëmendjen tuaj sot, ndoshta me ndikimin e miqve.



#### PESHQIT

Një nga projektet tuaja sot do të jenë blerjet për shtëpinë.

## BARSOLETA E DITËS



Një njeri e kishte dërguar televizorin te mjeshtri për ta riparuar. Mjeshtri e pyet:  
- Çfarë ka televizori?  
- Nuk e di, për nder. Isha duke e kruar veshin me gjilpërë kur, papritmas, iu ndal zëri.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

#### Çdo ditë në ora 16:00 Toy Story 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi;  
1 orë 40 min

**Rolet:** Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Madeleine McGraw (Bonnie), Christina Hendricks (Gabby Gabby), Don Rickles (Mr. Potato Head), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.

Regjia: Josh Cooley



#### Në ora 18:00 dhe 20:00

### AD ASTRA

Aventurë/Dramë/Mister; 2 orë 04 min

**Rolet:** Brad Pitt, Tommy Lee Jones, Ruth Negga, Liv Tyler, and Donald Sutherland

Regjia: James Gray




#### Çdo ditë në ora 22:00

### DOWNTON ABBEY

Dramë; 2 orë 02 min


**Rolet:** Hugh Bonneville, Jim Carter, Michelle Dockery, Elizabeth McGovern, Maggie Smith, Imelda Staunton, Penelope Wilton, etj.

Regjia: Michael Engler



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: Kino ABC.

## Brenda shtëpisë luksoze të Justin Bieberit



**S**htëpia turistike e Justin Bieberit është në shitje dhe ju mund ta bëni tuajën për vetëm katër milionë euro. E vendosur vetëm pak metra larg qytetit të Chesterit, Helsby Hill është një pronë me dy hektarë dhe përfshin një pishinë dhe një fushë futbollit.


Kjo është shtëpia ku 25-vjeçari ka qëndruar derisa performonte në Manchester Arena gjatë turneut të tij në botë. Blerësi me fat do të ndihet i sigurt me teknologjinë më të lartë të sigurisë, duke përfshirë dyert pa çelës dhe njohjen e gjurmëve të gishtërinjve.

## Jennifer Lopezi po mendon të bëjë fëmijë me Alex Rodriguezin



Jennifer Lopezi ka folur për mundësinë e të pasurit fëmijë me Alex Rodriguezin. Këngëtarja 50-vjeçare ka pohuar se binjakët e saj Max dhe Emme pëlqejnë të kenë një familje të përzier. "Unë mendoj se ata do të donin të kishin një vëlla ose motër.

Ata pëlqejnë vajzat e Alexit", ka deklaruar Jenniferi për "Extra". Ajo shtoi: "Ne duam të formojmë një familje të bukur dhe të përzier". Në fillim të këtij muaji Jenniferi konfirmoi për Hoda Kotb se do të donte të kishte më shumë fëmijë.



## Kimi tregon kur do ta publikojë Kanye albumin

**K**im Kardashiani thotë se albumi i ri i Kanye Westit nuk do të publikohet kur është parashikuar fillimisht. Ajo ka njoftuar fansat përmes "Instagram"-it se kur mund ta dëgjojnë atë.

"Kanye do të bëjë një seancë dëgjimi nesër në Chikago pastaj në Nju Jork të dielën. Ai do ta lëshojë albumin e vet të dielën", ka shkruar Kimi duke shtuar edhe një figurë në formë të lutjes.

## Akuzat nga fansat, Celine Dion: Kam qenë gjithmonë e dobët



**A**jo është e njohur për trupin e saj të hollë. Por tani Celine Dion, 51-vjeçare, po mbron veten kundër kritikëve që shqyrtojnë

figurën e saj të hollë. Në një intervistë të fundit për Entertainment Tonight këngëtarja kanadeze tha se ajo është gjithmonë shumë e hollë.

# Ajova dhe Kosova, miqësia që mposhti distancën

Filloi si bashkëpunim ushtarak midis Gardës Kombëtare të Ajovës dhe Forces së Sigurisë së Kosovës, por sot miqësia mes këtij shteti amerikan dhe Kosovës është shumë më e thellë. Arsimi, ekonomia, siguria dhe drejtësia janë vetëm disa nga fushat që këto dy shtete kanë partneritet. Në një intervistë për Zërin e Amerikës, guvernatorja e shtetit të Ajovas, Kim Reynolds tha se nëse krahason popullin e Ajovas dhe atë të Kosovës, dallimet janë krejtësisht të vogla. Të përbashkëtat e dy popullatave po bëjnë që miqësia të jetë e qendrueshme, ndonëse distanca mes tyre është shumë e madhe.

Shtetin e Ajovës dhe Kosovën i ndajnë rreth 8 mijë e 500 kilometra. Por distanca nuk ishte aspak problem për një dyqan vere në qytetin Johnston të këtij shteti amerikan. Tash e një kohë, në "Wine Styles" shitet një verë e prodhuar në Kosovë. Pronari i dyqanit, Allan Graham thotë se klientët e tij, veç shijes


jnë dhe të gjejmë mënyra të reja bashkëpunimi", thotë guvernatorja e shtetit të Ajovas, Kim Reynolds.

Fusha më e fortë e bashkëpunimit vazhdon të jetë ajo e ushtrisë. Vetëm javën që shkoi në Ajova qëndruan për 10 ditë katër pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në kuadër të trajnimit për reagim në raste të katastrofave natyrore.

"Sigurisht ka qenë një kohë e shkurtër, mirëpo ndikimi i këtij ushtrimi është shumë i madh. Dhe ky ushtrim është jashtëzakonisht i vlefshëm për neve si një forcë e re në Ballkan", thotë Drilon Rama, Toger në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

"Pra këto mësimet që i kemi marrë nga Garda Kombëtare e Ajovës, padyshim se do t'i implementojmë kur të kthehemi në njësitet tona. Duke pasur parasysh se çdo përvojë e marrë këtu do të ndikojë në zhvillimin e njësitëve tona", thotë Bujar Ferizi, kapiten në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Marrja e përvojës nga garda e



mendoj se Kosova është në pozitë shumë të mirë sot për shkak të këtij raporti shumë të shëndosh mes Gardës Kombëtare të Ajovës dhe ushtrisë tuaj", thotë Guvernatorja e shtetit të Ajovas, Kim Reynolds.

Planet janë që Kosova të marrë përvojë në Ajova edhe në fushën e energjisë së ripërtëritshme, sektor ky që guvernatorja e këtij shteti thotë se janë të parët.

"Kemi disa biznese që janë duke punuar që të vendosen në Kosovë, në veçanti në fushën e energjisë së ripërtëritshme. Dhe nga ana tjetër të kemi biznese nga Kosova në Ajova është fantastike. Kemi folur gjatë për sipërmarrësit e rinj dhe mundësitë që egzistojnë, në mënyrë që të sjellim ata nga Kosova që të shohin infrastrukturën dhe mundësitë tona. Po na merr pak kohë që të arrijmë deri në atë pikë. Por shpresojmë që të krijoni ekosistemin më të mirë sesa që kishim ne në fillimet tona. Dhe të ndajme, ne kemi ide për Kosovën dhe Kosova mund te ketë ide për ne", thotë guvernatorja Reynolds.

Kosova është vend i vetëm që ka konsullatën e saj në këtë shtet amerikan. Prania e stafit diplo-

matik të Kosovës në Des Moines, e bën Kosovën pjesëmarrëse në shumë ngjarje kulturore që ndodhin në kryeqytetin e Ajovas.

Javën që shkoi, Kosova kishte hapësirën e saj të veçantë në kuadër të festivalit ndërkombëtar të ushqimit dhe muzikës. Rëndësia e pjesëmarrjes në këto ngjarje është e madhe.

"Është shumë e rëndësishme sepse në fillim kur kemi hapur konsullatën nuk është se shumica e kanë ditur ku ndodhet Kosova. Prandaj janë të rëndësishme, përveç marrëdhënieve me institucione në këto fusha tjera të bujqësisë, ekonomisë apo edukimit të kemi edhe të dijnë njerëzit pak më shumë kulturën tone, se çfarë ushqime ne kemi", thotë Rinora Jelliqi nga Konsulata e Kosovës në Des Moines.

Kuzhinieri nga Kosova, Përparim Babalija, ishte pjesëmarrës në këtë festival, i cili u prezantoi pjesëmarrësve të festivalit shijen tradicionale shqiptare.

"Ne kemi bërë diçka, një gatim shumë të thjeshtë, por që është nga zona e Kosovës. Kemi bërë birjan me vezë dhe oriz. Kemi bërë kaçamakun e Kosovës me

miell misri të bardhë, me ajkë dhe me djath të deleve, kemi bërë edhe një shalqir me djath dhe tartufin e zi sepse ne tradicionalisht shalqirin e kemi përdorur në familjet tona, me bukë dhe me djath. Kjo është një pjatë që ne sot mund t'a modifikojmë, pasi në Kosovë kemi shumë tartuf dhe tartufi duhet të jetë si një lënd e parë që ne duhet të mburremi që kemi sasi shumë të madhe. Dhe ne do të bëjmë një pjatë ku bashkojmë produktet e Kosovës në një pjatë moderne", thotë kryekuzhinieri që erdhi nga Prishtina në Des Moines të Ajovas, Përparim Babalija.

Guvernatorja Reynolds thotë se sa më shumë që dy popujt mësojnë kulturën e njëri tjetrit, lidhja sa vjen e forcohet.

"Mendoj se ka shumë ngjashmëri. Të gjithë thonë se kur udhëton në Kosovë ndihesh sikur je në Ajova. Njerëzit janë të ngrohtë dhe të sinqertë, të kujdesshëm dhe po me këto fjalë mund t'i përshkruaj edhe banorët e Ajovës. Sepse ne kujdesemi për njerëzit, komunitetin, mundohemi të ofrojmë mundësi për secilin dhe të njëjtën ndjenjë më japin të gjithë ata që vijnë nga Kosovan në Ajova. E dua rininë në popullësinë e Kosovës, mendoj se është e mrekullueshme dhe nga ajo perspektivë hapen shumë mundësi. Prandaj mendoj se është marrëdhënie që do ta shohim të rritet", thotë ajo.

Para disa ditësh, 28 studente nga Kosova filluan studimet në kolegjin e komunitetit të Des Moines, mundësuar nga fondacioni Millenium me fondet e qeverisë amerikane.

Ato do të studiojnë në fushën e energjisë në programe dy vjeçare, për t'u kthyer më pas në Kosovë për të zhvilluar këtë sektor. /VOA



së verës Stone Castle mësojnë shumë edhe për vendin ku prodhohet ajo.

"Jo shumë njerëz e dinë që vera vjen nga Kosova, prandaj ajo që më pëlqen të bëj është t'u ofroj një kampion të verës pa u thënë gjë për origjinën e saj dhe pres reagimin, i cili gjithmonë është shumë pozitiv. Klientët mbesin të shtangur kur kuptojnë se çfarë është dhe prej nga vjen. Pastaj interesohen të dinë më shumë për vendin nga vjen kjo verë. Mendoj se nëse u thua se nga vjen para se ta provojnë atë pritjet janë tjera. Pastaj ka shumë njerëz që thonë se mendova se kjo verë ishte nga Kalifornia", thotë pronari i dyqanit Allan Graham.

Ky bashkëpunim erdhi si rezultat i një raporti të veçantë partneriteti që Ajova dhe Kosova kanë nga viti 2013, kur dy shtetet nënshkruan marrëveshjen e shteteve simotra.

"Është rritur fuqishëm në fusha të ndryshme, marrëdhënia dhe mundësitë për të punuar bashkë në arsim, bujqësi, ushtri, polici, zbatim të ligjit dhe vazhdojmë të bashkëpunojmë


Ajovës, bëri që Kosova sot të ketë ushtrinë e saj me kapacitete të larta, thotë Guvernatorja Reynolds.

"Jam shumë krenarë për pjesëtarët e gardës që shërbejnë në ushtri. Ishte mundësi e jashtëzakonshme të krijojmë mundësitë të ndajmë infrastrukturën dhe mënyrën e menaxhimit. Jemi krenarë me burrat dhe gratë që kaluan kohë në Kosovë, sikur që edhe ju kishit prani ushtarake në Ajova duke punuar bashkërisht dhe





# Ismail Kadare, një rrëfim për sekretet e romaneve dhe çmimin më të fundit



Shqipëria, një vend i vogël në Gadishullin Ballkanik, ra në komunizëm pas përfundimit të Luftës Botërore. Për dekada, ajo që njerëzit thonin dhe shkruanin u censuroi rreptësisht në Shqipërinë komuniste.

Ismail Kadare, shkrimtari 83-vjeçar shqiptar ishte adoleshent kur iu fut rrugës së letërsisë duke kopjuar me dorë Makbethin e Shekspirit dhe bëri emër si një romancier në moshë 27 vjeçare me romanin e tij të parë "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" (1963).

Kadare kërkoi politik në Francë në 1990 dhe vazhdon të shkruajë atje që atëherë. "Bota ende nuk e kupton sa tragjike është të jetosh në një vend që nuk e do letërsinë. Letërsia është gjëja më e çmuar në jetë," shkruan Kadare në një intervistë të dërguar me email.

**Besoj se ju keni mësuar pak për shkrimtaren korean Pak Kyongni pasi jeni njoftuar për çmimin. Ç'mendim keni për të?**

Kam dëgjuar fjalë shumë të mira për shkrimtaren Pak Kyongni dhe më duket një fakt shumë i bukur, që ky çmim mban emrin e saj. Gjithashtu, është një gëzim për mua që këtë çmim e ka marrë para meje një shkrimtar që e çmoj shumë si Amos Oz, një nga miqtë e mi më të mirë. Letërsia është e tillë, ka në thelbin e saj globalizmin. Ne jetojmë në një shtëpi të madhe, që quhet tokë, glob tokësor. Në thelbin e saj, është universale, e përjetshme, e pamoshë, e pa vend, në kuptim e pa caktuar në një vend. Ndjehem i nderuar

që e kam fituar këtë çmim në Korenë e Jugut.

**Në 1970, Parisin e përshkroi një stuhi letrare, botimi i "Gjenerali i ushtrisë së vdekur". Një libër i cili ju ka dhënë një emër të madh në botën letrare. Si lindi ky roman?**

Ka filluar si një tregim i shkurtër, mbresë. Por është e bukur si fakt që të jep jeta ndonjëherë. Jeta shpesh nuk te jep fakte të bukura, por i krijon shkrimtari. Në këtë rast është një dhuratë, një ngjarje e pazakonshme që ka brenda diçka që kapërcen vetveten. Një mision i çuditshëm, që ndodh në botë shumë rrallë, që ndodh midis dy vendeve shumë rrallë. Dhe që ndodhte në Shqipëri në një atmosferë jo të përshtatshme për të. Do me thënë, vinë përfaqësues të një ushtrie që ende quhej e NATO-s, armiqësore për ne, për të kryer një mision njerëzor, të cilin Shqipëria komuniste dhe nuk e kuptonte mirë.

Shqipëria s'ishte mësuar me mallëngjimet e vjetra, të kaluara, të stërkaluara, të harruara, të paharruara, të fajit, të jofajit. Pra ishte një subjekt, një ngjarje që të jepte liri. Por liria në këtë rast, dhe befasia, janë të përshtatshme për letërsinë por janë të rrezikshme në një vend ku liria nuk çmohet, në një vend ku liria, përkundrazi, të kall frikën. Kjo është. Kjo kundërthenie, bëri që unë t'i kthehesha shumë herë kësaj teme, sepse sapo e shkrova, m'u duk se ishte më e thellë, gjithmonë se ç'mendova në fillim, më e thellë, më e ngatërruar, më problematike. Nisi si tregim, pas-

taj u pasuria si novelë, u botua në shtyp, pastaj u kritikua.

**Ky është romani më i njohur në botë i juaj, por sipas mendimit tuaj nuk është romani më i mirë, apo jo?**

Unë mendoj që nuk është romani im më i mirë, por më i njohuri, vërtet pasi unë kam qenë shumë i ri kur e kam shkruar, njëzet e pesë vjeç, shkrimtar i ri në një vend, domethënë, në një rend shoqëror të mjerë, të trishtueshëm, jashtëzakonisht armiqësor për letërsinë, për një talent. Dhe në fillim, sigurisht unë s'krijova... një temë e tillë s'të krijonte asnjë afërsi me shoqërinë socialiste, me shtetin, me klimën, gjithçka ishte e kundërt me atë që neve e kishim bazuar artin tonë, letërsinë tonë të realizmit socialist.

Bazohej në një gjë shkretanë, një gjë jashtëzakonisht e trishtueshme për artin. Gëzimi, optimizmi, qielli ishte blu, që shndriste. Kurse ky ishte një roman me baltë, shi dhe vdekje. Ishte i mbarë si letërsi por krejtësisht i mbrapshtë për vendin ku jetoja.

**Në romanin tjetër tuaj, "Pallati i Ëndrrave", ju iu afruat shumë afër rrezikut, duke jetuar në një vend diktatorial si Shqipëria, ku pavarësisht nga alegoria, ishte e qartë që ju i bënit autopsy vendit ku jetonit?**

Unë nuk u nisa me këtë qëllim, si të thuash që, po ia hedh regjimit me një temë jo të përshtatshme për të. Në letërsi, zakonisht, shkrimtarët seriozë, nuk nisen

nga dikanëri të tilla. Vetvetiu tema e tillë, e shtypjes së njeriut, është e natyrshme, dhe meritat e tij, ose mosmerita e tij, është që ta vërë re këtë gjë ose të mos e vërë re këtë gjë.

**Cilët shkrimtarë ju pëlqejnë dhe cilat vepra konkretisht?**

Mua më ka pëlqyer letërsia dramatike, për arsye që mund t'i duken një lexuesi, një kritiku, një studiuesi, një akademiku, mund t'i duken mjaft banale. Është një lloj si të habitesh pse fëmijëve iu pëlqejnë tmerret ndonjëherë. Fëmija sa është natyrë e padjalëzuar, e pastër, aq më shumë do të shikojë tmerrë të frikshme, të kundërta. Dhe unë kur isha fëmijë, më tërhiqnin shumë fantazmat, dhe pak a shumë, shtëpia ku banoja ishte e tillë – në Gjirokastër – që ma nxiste këtë përfytyrim. Ma nxiste përfytyrimin e frikshëm.

Këtë çudi ma ma nxiti edhe një shkrimtar që unë s'kuptoja çfarë ishte dhe ai quhej Shekspir, nga Anglia, i përkthyer, dhe u mahnita, se libri quhej "Makbeth". Sigurisht e shfletova në fillim, pastaj e shfletova me kujdes, e lexova një më një, nuk kuptova thelbin e tij, s'mund ta kuptoja se ishte vepër shumë e thellë. Por ama u kënaqa shumë që atje kishte magjistrica, fantazma, që uleshin në tryezë, që vinin iknin. Më pëlqente çdo gjë e këtij libri dhe m'i errësoi të gjithë librat e tjerë. Shekspiri më errësoi çdo letërsi tjetër, edhe atë greke. Shekspiri ishte kaq i ashpër dhe dramatik, impresionant. Homeri më pëlqente, por, normalisht, ashtu si edhe të tjerëve.

Kjo ishte diçka e mirë se më mbajti në ekuilibër, që të mos degradonte fantazia ime vetëm për tmerre. Për çudi, ai që më ekuilibroi vërtetë ishte Servantesi me "Don Kishotin". Nëse në veprën time ndjehet humori, këtë e kam nga Don Kishoti.

**Cila është këshilla që mund t'u jepni shkrimtarëve të rinj kudo në botë?**

Botimi i hershëm mund të jetë mbase edhe fatal. Për fat të keq, që më vonë m'u shndërrua në mbarësi, emri im doli në shtyp si shkrimtar, shumë përpara se të isha shkrimtar. Më doli në mënyrë qesharake, në një përgjigje të gazetës "Letrari i ri", te rubrika "Posta e redaksisë". Përgjigja ishte tallëse për mua: "Ismail Halit Kadare.

Lexuam vjershat tuaja, por ato, të mos ju vijë keq, që po jua themi, por janë shkruar në një gjuhë që letërsia nuk i pranon fare." Kishin botuar dhe strofën time të parë. Unë që as doja t'ia dija se çfarë më shkruanin, por isha i mrekulluar nga emri im i shtypur për herë të parë në gazetë. Mendoj se ashtu si pija u ndalohet adoleshentëve, mund t'u ndalohet edhe të botojnë herët.

**Çfarë do donit t'i thonit lexuesit tuaj korean?**

Lexuesit koreanë dua t'i shpreh mirënjohjen, sepse ka treguar interesim për veprën time, po ashtu edhe përkthysve dhe botuesve koreanë që kanë sjellë në këtë vend të largët mbi dhjetë libra të mi. /Gazeta Shqip

# 10 tipat e çuditshëm në një vend pune, që nga thashethemexhiu e deri tek të dashuruarit

Shpesh për të qenë të lumtur dhe të kënaqur me punën, nuk mjafton vetëm një pagë e mirë në proporcion me pozicionin tuaj, apo të punoni në kompaninë e ëndrrave, por është aq e rëndësishme të ndërtoni një marrëdhënie pozitive me kolegët në punë.

Të gjithë e dimë, se kjo gjë është më e lehtë të thuhet se të bëhet. Shpesh në punë jemi të detyruar të punojmë me njerëz të cilët nuk na pëlqejnë, me të cilët është e vështirë të ndërtohet një dialog, pavarësisht se i kemi pranë tryezës sonë të punës. Por ka edhe nga ata kolegë, që janë të gatshëm të bëjnë gjithçka, vetëm e vetëm që të bien në sy të drejtuesve.

Pikërisht me këta persona kalojmë pjesën më të madhe të ditës, se sa me njerëzit e familjes. Është e rëndësishme – për të mos thënë thelbësore – krijimi i marrëdhënieve me personat me të cilët punojmë, dhe, edhe më e rëndësishme, të pasurit e marrëdhënieve të mira me ta.

Më poshtë janë 10 tipa kolegësh që me siguri do t'ju ndodhë t'i takoni në çdo vend pune...

## 1. Thashethemexhiu

Edhe një agjent i CIA-s do ta kishte zili. Di gjithmonë gjithçka, më parë se të tjerët. Duhet t'i drejtoheni pikërisht atij për të ditur lajmin që po kërkoni, di në detaje se cili është kolegu i ri në punë dhe ka gjithnjë informacion për strategjinë e korporatës. Ose e do, ose e urren, dhe jo gjithnjë, për atë çfarë thotë është i dobishëm, por në mijëra informacionet që tregon, do të jetë gjithnjë ai që do t'ju shërbejë ju. Vendi ideal për të krijuar marrëdhënie me të është pranë makinës së kafesë, aty ku përditësohet me të gjitha "të rejtat"

## 2. Kolegu që shkëlqen gjithnjë

Mund të cilësohet "Tom Cruise i kompanisë". Nuk e humb kurrë entuziazmin, vrapon nga një departament në tjetrin, të gjithë e duan, veçanërisht shefat. Është e vështirë t'i qëndrosh pas, pasi është ai që merr gjithnjë nismën dhe duket se nuk gabon asnjëherë. Por si është e mundur që ka gjithnjë përgjigjet e duhura? Nuk do ta dimë kurrë. Ky tip personi ka shpesh karizmën e liderit dhe në njëfarë mënyre do të hyni pa e



kuptuar në orbitën e tij, të tërhequr prej tij, si nga një Diell.

## 3. Kolegu që ankohet gjithnjë

Ai ka gjithnjë një problem... me shefin, Burimet Njerëzore, pagën e fundit, madje edhe me makinën e kafesë apo ajrin e kondicionuar. Për të, asgjë nuk shkon siç duhet dhe nuk bën gjë tjetër, veçse e ndan frustrimin e tij me të gjithë. Në pjesën më të madhe të rasteve, këtyre njerëzve përipiqemi t'u qëndrojmë larg, por mund të ndodhë që të ngecim në "rrjetën" e tyre dhe të dëgjojmë gjithë pakënaqësitë që kanë.

## 4. Vjedhësi i zemrave

Ka njerëz që tërheqin vëmendjen tuaj menjëherë sapo i shihni. Ata shndrisin gjithnjë dhe ju nuk do të lodhesht t'i dëgjoni për orë me radhë. Në çdo vend pune ekziston një "vjedhës zemrash" dhe ky tip personi është i vetëdijshëm për bukurinë që zotëron. Shpesh, vjedhësit e zemrave nuk janë një autoritet i vërtetë brenda kompanisë, por i përdorin armët që zotërojnë për t'ju bërë që ta besoni. E vërteta është se këta persona e duan vendin e punës ku punojnë, janë madje të besueshëm e gjithnjë të pranishëm, ata nuk mungojnë asnjëherë në mënyrë të pajustificuar.

## 5. Kolegu që thotë gjithnjë "po" (yes-man)

Ai i thotë gjithnjë po, çdo propozimi,

çdo detyrë, çdo qortimi. Nuk humb asnjëherë rastin për t'i bërë përshtypje drejtuesit. Zakonisht "yes-man" formojnë një grup të bashkuar, rrinë dhe flasin vetëm me njëri-tjetrin (dhe me shefin), vijnë të parët në punë dhe largohen të fundit. Ata nuk janë shumë të dashur në mesin e kolegëve të tjerë, pasi shpesh kërkojnë të drejtën t'ju thonë se çfarë duhet të bëni dhe si duhet ta bëni dhe nuk e humbin asnjëherë rastin të shkojnë te drejtuesi dhe të raportojnë se çfarë keni bërë (dhe sipas tyre, çfarë nuk duhet të kishit bërë, ose të paktën jo në atë mënyrë).

## 6. I urituri

E gjeni gjithnjë duke ngrënë diçka... Pavarësisht nëse është uria e shkaktuar prej nervozizmit apo metabolizmi që punon me shpejtësinë e dritës – këtë gjë nuk do ta dimë asnjëherë – e vetmja gjë që dimë është se tryeza e tij e punës është gjithnjë e shtruar (dhe e çrregullt), dhe goja e tij gjithnjë plot. Aromat që shpërndahen në zyrë janë gjithnjë vepër e tij.

## 7. Kolegu gjithnjë i gjindshëm

Nëse keni një projekt për të përfunduar dhe jeni të detyruar të vini në zyrë në orën 6:00 të mëngjesit dhe të largoheni në mbrëmje në orën 11:00, jini të sigurt, se "ai do të jetë". Kolegu gjithnjë i gjindshëm bën pjesë në atë kategori kolegësh që nuk fle kurrë, janë gjithnjë të gjithnjë të angazhuar. Dhe ju do të pyesnit: po ata, a kanë shtëpi?

## 8. Kolegu simpatik

Ka gjithnjë batutën gati dhe në çdo ngjarje të kompanisë do ta shihni protagonistë të një ndodhie të bukur apo një serie me barsoletash. Nuk ka asgjë që t'ia prishë humorin dhe është në gjendje të shtensionojë çdo situatë. Ju do t'i gjeni gjithnjë pas vetes në momentet më të papritura, për t'ju thënë ndonjë perlë...

## 9. Polemiku

Disa persona përipiqen t'i shmangin diskutimet, ndërsa të tjerë duket se kanë lindur për polemika. Me këta tipa, diskutimi rrezikon të marrë tone të larta. Në takime pune nuk e humbin asnjëherë rastin të nxjerrin në pah që diçka nuk është bërë ashtu siç ata pretendojnë se duhet të ishte bërë dhe mund ta shndërojnë takimin në një fushë të minuar.

## 10. Çifti i dashuruar

Kur kaloni shumë kohë në një mjedis të caktuar, është e lehtë t'ju hyjë dikush në zemër, që e frekuenton, po aq sa ju, këtë ambient, dikush me të cilin ndani momente pozitive apo negative, dikush të cilin e shihni çdo ditë dhe me të cilin të flisni edhe për tema që nuk lidhen me punën. Disa flirte mbeten të tilla, por dashuria mund të lindë edhe brenda mureve të punës. Disa çifte mund ta thonë këtë gjë, të tjera përipiqen ta mbanin lidhjen e tyre të fshehtë mes kolegëve. Në këtë rast, dyshimi mund të jetë i bezdisshëm, por gjithsesi privatësia duhet respektuar. /gazeta-shqip

# Industria e kanabisit në Maqedoni mund të arrijë në 100 milion euro në vit

Maqedonia e Veriut është në listën e shteteve evropiane që kanë legalizuar kanabisin për qëllime mjekësore. Që prej se janë bërë ndryshimet ligjore më 2016, për të legalizuar industrinë e kanabisit, deri më tani janë regjistruar 23 kompani për prodhimin e kanabisit që përdoret për qëllime mjekësore, prej të cilave, dy kompani prodhojnë vaj kanabisi.

Autoritetet qeveritare thonë se ky biznes pritet t'i sjellë shtetit përfitime, që mund të shkojnë deri në 100 milionë euro në vit.

Por, kompanitë që kanë fituar licencën për prodhimin e kanabisit, kërkojnë që ligji sërish të pësojë ndryshime, me qëllim që ata të mund të eksportojnë lule të thata të kanabisit me qëllim që biznesi për prodhimin e kanabisit për qëllime mjekësore të mund të ketë perspektivë. Ata thonë se gjatë vitit 2018, kanë investuar 3,3 milionë euro në këtë industri, ndërkohë që si fitim kanë paraqitur vetëm 300 mijë euro.

Në depot në Maqedoninë e Veriut, tashmë kanë skaduar lulet e thata të kanabisit që ishin në vlerë prej 60 milionë eurosh, ndërkaj, me ligj është i ndaluar eksporti i tyre.

Konstandin Dukovski, kryetar i Shoqatës së prodhuesve të kanabisit për qëllime mjekësore "Makkanabis", thotë se Ligji për kontrollin e barnave dhe substancave psikotrope duhet të pësojë ndryshime, në mënyrë që ata të mund të eksportojnë lule të kanabisit.

"Me eksportin e lules së kanabisit, ne do të mund të arrijmë që më shpejtë të plotësojmë standardet që kërkohen në shtetet e zhvilluara të Evropës", thotë Dukovski për Radion Evropa e Lirë.



Përderisa organizatat që përkrahin dekriminalizimin e kanabisit, thonë se është e padrejtë që kompanitë të kenë të drejtë të mbjellin qindra rrënjë kanabisi, ndërkaj, të sëmureve të mos u lejohet të mbjellin sasi të vogla të kanabisit, për nevoja personale.

OJQ-të shprehen mjaft kritike, duke thënë se shteti nuk e ka legalizuar këtë industri, por e ka privatizuar atë, duke iu dhënë leje vetëm personave të caktuar që të merren me industrinë e kanabisit. Ato kërkojnë që Maqedonia e Veriut t'iu referohet praktikave të vendeve të

zhvilluara evropiane dhe të krijojë më shumë lehtësi për mbjelljen e kanabisit me pakicë, për nevoja persona të personave që vuajnë nga kanceri.

"Ligji për kontrollin e barnave opioid dhe substancave psikotrope është dizajnuar në atë mënyrë, që sipas mendimit tim ka për qëllim të eliminojë konkurrencën dhe këtë biznes ta orientojë tek ata që kanë lidhje të fuqishme me politikën", thotë Janaki Mitrovski nga shoqata "Billka".

Në industrinë e prodhimit të kanabisit për qëllime mjekësore është e përfshirë

edhe familja e kryeministrit maqedonas, Zoran Zaev. Kushëriri i tij, Trajçe Zaev, është njëri nga investitorët më të mëdhenj në këtë industri.

Së fundmi, në opinion u shkaktuan shumë polemika, lidhur me statusin e sipërmarrësit amerikan Mike Straumietis, i cili merret me këtë industri. Pas një takimi me kryeministrin Zaev dhe ministrin e Shëndetësisë, Venko Filipçe, ai kishte deklaruar se Maqedonia e Veriut ka një potencialë të madh në prodhimin e kanabisit dhe se ndjehet i ngazëlyer që do të jetë pjesë e siç ka thënë, shndërrimit të Maqedonisë së Veriut në njërin prej superfuqive të para të prodhimit të kanabisit në Evropë.

Por, njohësit e çështjeve ekonomike druajë se Maqedonia e Veriut si shtet, nuk ka potencial juridik që të kontrollojë industrinë e kanabisit.

"Është shumë e qartë se Maqedonia e Veriut si shtet nuk ka kapacitet që të garantojë se një biznes i tillë nesër, në këtë shtet, do të jetë i kontrolluar nga institucionet. E dinë e gjithë Evropa se institucionet e shtetit, në këtë gjendje siç janë, nuk kanë kapacitete administrative", thotë ish-ministri i Financave, Xhevdet Hajredini.

Qeveria e Maqedonisë së Veriut, ndërkaj, nuk ka bërë publike të dhënat për sipërfaqet e mbjella me kanabis.

Vaji i kanabisit dhe disa medikamenteve që kanë përqendrim të lartë të marihuanës, pacientët mund t'i blejnë në farmaci me recetë mjekësore. Sipas ligjit, ilaçet e tilla mund t'i rekomandojnë specialistët, për pacientët me sëmundje të rënda malinje.

REL



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

# Derbi i Dritës

Ish-kampionia e Kosovës, Drita, me golin e Ardian Cuculit arriti ta mposhtë skuadrën e Gjilanit në derbin më të madh në vend. Në javën e shtatë tri ndeshjet e zhvilluara të shtunën i fituan skuadrat vendëse, kurse të dielën fituese në tri ndeshjet e tjera dolën skuadrat mysafire



dhe Maloku shënuan golat për mitrovica-sit, kurse golin e nderit për kuqezinjtë e kryeqytetit e realizoi Taloviq. Fitore të mundimshme arriti skuadra e Llapit ndaj Dukagjinit (2-1). Armin Mujkiq i kaloi llapjanët në epërsi në minutën e 40-të. Dukagjini barazoi shifrën në minutën e 67 kur shënoi Husein Demiri, vetëm dy minuta pasi Llapi mbeti me një lojtar më pak pas përjashtimit të Kastriot Selmanit. Fitoren vendësve ua siguroi në minutën e 80 Mërgim Pefqeli që realizoi për 2-1.

**IPKO SUPERLIGA**

Gjilani - Drita	0-1
Vushtrria - Prishtina	0-3
Drenica - Ballkani	0-1
Feronikeli - Ferizaj	5-0
Llapi - Dukagjini	2-1
Trepça '89 - Flamurtari	5-1

**Tabela**

1. Feronikeli	7	15 pikë
2. Drita	7	14
3. Llapi	7	14
4. Ballkani	7	14
5. Prishtina	7	13
6. Gjilani	7	12
7. Trepça '89	7	9
8. Drenica	7	8
9. Flamurtari	7	7
10. Ferizaj	7	6
11. Vushtrria	7	5
12. Dukagjini	7	1

Në xhiron e radhës takohen: Feronikeli-Llapi, Dukagjini-Trepça '89, Ferizaj-Ballkani, Drita-Vushtrria, Flamurtari-Gjilani, Prishtina-Drenica.

**LIGA E PARË**

Trepça - 2 Korriku	2-0
Onix - Drenasi	0-0
Ulpiana - Ramiz Sadiku	0-2
Vëllaznimi - Malisheva	0-2
Dardana - Vllaznia	2-0
Arbëria - KEK-u	3-1
Istogu - Besa	1-0
Liria - Vitia	5-0

**Tabela**

1. Istogu	6	16 pikë
2. Malisheva	6	13
3. Liria	6	13
4. Dardana	6	12
5. Besa	6	10
6. Trepça	6	10
7. Arbëria	6	10
8. Drenasi	6	9
9. Onix	6	7
10. 2 Korriku	6	7
11. Vllaznia (P)	6	6
12. Ulpiana	6	5
13. Ramiz Sadiku	6	4
14. KEK-u	6	4
15. Vitia	6	4
16. Vëllaznimi	6	3

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Java e shtatë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll ka qenë shumë interesante, kurse derbin e kësaj xhiroje e ka fituar Drita në përballje me Gjilanin. Në tri ndeshjet e zhvilluara të shtunën fituese kanë dalë skuadrat vendëse, kurse në tri ndeshjet e tjera të zhvilluara të dielën fituese kanë dalë skuadrat mysafire.

Skuadra e Dritës e mposhti rivalin lokal, Gjilanin, me rezultat 0-1, kurse golin e vetëm në këtë ndeshje e shënoi në minutën e 29. Ardian Cuculi realizoi me kokë pas një harkimi të Xhevdet Shabanit nga gjuajtja e lirë. Rastet në pjesën e dytë nuk munguan, por gola të tjerë nuk pati dhe fitores në derbin më të madh iu gëzua Drita, e cila tash renditet e dyta me 14 pikë. Ndërsa skuadra e Gjilani bie në pozitën e gjashtë me 12 pikë.

Fitores së tretë nën udhëheqjen e trajnerit Armend Dalliu i është gëzuar skuadra e Prishtinës, e cila më lehtë sesa që është prituri e ka mposhtur skuadrën e Vushtrrisë (0-3). Pas dy minutave lojë kryeqytetasit i kaloi në epërsi Alban Shillova. Tre minuta pa përfunduar pjesa e parë erdhi edhe goli i dytë i mysafirëve, kësaj radhe në portën e vet shënoi Nertil Hoxha. Golin e tretë dhe të fundit në ndeshje e shënoi kapiteni Armend Thaqi

në minutën e 56-të. Tri pikë si mysafir i ka arkëtuar edhe skuadra e Ismet Munishit, Ballkani, që ka arritur fitore kundër Drenicës në Skenderaj (0-1). Klubit nga Suhareka i mjaftoi goli i shënuar nga Jetmir Topalli (5') për t'i marrë pikët maksimale. Në këtë mënyrë skuadra e Ballkanit vazhdon të jetë në krye të tabelës me vetëm një pikë më pak se skuadra e parë, Feronikeli. Drenica është e teta me 8 pikë.

**Fitojnë Feronikeli, '89-shi dhe Llapi**

Fitoreve të shtunën i janë gëzuar Feronikeli, Trepça '89 dhe Llapi pasi kanë mposhtur Ferizajn, Flamurtarin dhe Dukagjinin. Kampioni i elitës, Feronikeli, në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas e mposhti me rezultat bindës skuadrën e Ferizajt (5-0). Sulmuesi Kastriot Rexha e hapi serinë e golave pas tetë minutave lojë, kurse katër minuta më vonë realizoi edhe golin e dytë. Për 3-0 u përkujdes sulmuesi Mendurim Hoti (39'), derisa dy golat e tjerë në pjesën e dytë i shënoi Haxhi Neziraj (53', 64'). Që nga minuta e 21-të Ferizaj luajti me një lojtar më pak, pas përjashtimit të Dardan Jasharit.

Fitore bindëse shënoi edhe skuadra e Trepçës '89, e cila deklaroi Flamurtarin me shifrat 5-1. Arb Manaj, Traore, Emiri, Rusi

**SHKURT**

**Rashica i lumtur që rikthehet me gol**

Ylli i Përfaqësues së Kosovës, Milot Rashica, është rikthyer me gol pas lëndimit në skuadrën e Werder Bremenit. Kjo e fundit luajti të shtunën baras 2-2 me Borussia Dortmundin. "Treguam frymë të madhe ekipore. Jam i lumtur që shënova në rikthimin tim në lojë", ka shkruar Rashica në llogarinë e vet në "Instagram". Rashica si pasojë e lëndimit ka humbur katër ndeshje me Werder Bremenin dhe dy me përfaqësuesen e Kosovës.

**Sulmuesit shqiptarë në formë, shënojnë Cikallesi dhe Balaj**

Sulmuesit e Shqipërisë duken në formë të mirë, pasi kanë arritur të shënojnë duke konfirmuar formën e mirë pak ditë para grumbullimit të kombëtares për ndeshjet e tetorit. Sokol Cikallesi realizoi dy gola në fitoren e Akhisar Belediyesporit si mysafir i Fatih Karagumruk (2-3). Sulmuesi kuqezi realizoi brenda pak minutash, kurse gol ka shënuar edhe Bekim Balaj në fitoren e Sturm Grazit 4-1 ndaj Admira Moedlingut. Sulmuesi shtatlartë shënoi golin e tretë për skuadrën e tij në fillim të pjesës së dytë.

**Hasani priti ish-kikboksierin me famë botërore, Azem Maksutajn**

Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), Besim Hasani, ka prituri në takim ish-kampionin e botës në kikboks, Azem Maksutajn. Maksutaj shoqërohej me një delegacion të Federatës së Muaythait të Kosovës (FMTHK), kryetarin Shpëtim Ahmetajn, njëkohësisht kampion bote në kikboks, Jens Wilke, gjyqtar i deleguar nga Federata Botërore e Muaythait, Arben Januzi, përzgjedhës i FMTHK. Presidenti Hasani, duke i përgëzuar mysafirët për kontributin që po e japin në zhvillimin e muaythait në Kosovë, i uroi për organizimin e kampionatit të parë shtetëror që u mbajt në Prishtinë. Hasani shprehu edhe një herë mbështetjen e KOK-ut në zhvillimin e muaythait si dhe për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, me ç'rast në fillim të muajt shtator dhjetëra përfaqësues të këtij sporti kryen me sukses kursin për administratorë sporti. Maksutaj dhe mysafirët e tjerë falënderuan presidentin Hasani për pritjen dhe kontributin e vazhdueshëm për formimin dhe zhvillimin e federatës.

## Përplasja Ramos - Simeone, mbrojtësi rrezikon dënim të madh

MADRID, 29 SHTATOR - Në "El Clasico", që u mbyll pa gola, surpriza më e madhe u regjistrua jashtë fushës së lojës. Vazhdon me polemika jehona e sfidës së parë sezonale në La Liga, mes Atletico Madridit dhe Real

Madridit. Mediet iberike raportojnë për një sherr mes Diego Simeones dhe Sergio Ramos në tunelin që të çon në dhomat e zhveshjes në stadiumin "Wanda Metropolitan". Trajneri Atletico dhe kapiteni

i Realit u përplasën fort verbalisht, ndërsa ndërhyrja e futbollistëve dhe stafeve teknike evitoi përplasjen fizike. Gjithçka nisi në fundin e pjesës së parë. Siç duket qartë në këtë video, Sergio Ramos iu drejtua me fjalë

fyese Simeones. Përpara kamerave nuk ndodhi asgjë, ndërsa në tunel të dy u përballën sërish dhe për pak u kapën me grushte. Atletico Madridi ka vendosur ta paraqesë në Komisionin e Disiplinës sjelljen në fushë të



Sergio Ramosit që, sipas medieve, rrezikon një pezullim deri në katër ndeshje.

## Muriqi: Ofertat po më motivojnë, dua të bëhem legjendë në Fenerbahçe



ISTANBUL, 29 SHTATOR - Vedat Muriqi nuk ka arritur të shënojë gol në derbin e Stambollit, ku skuadra e tij Fenerbahçe ishte mysafire e Galatasarayt. Sulmuesi nga Kosova bëri një paraqitje jashtëzakonisht të mirë, duke marrë skuadra e tij një pikë tejet të vlefshme. Gjatë ndeshjes Muriqi edhe u gjakos gjatë një dueli në ajër, derisa gjatë gjithë pjesës së dytë e barti fashën në kokë. Pas ndeshjes prizrenasi foli për rrjedhën e lojës, duke thënë

se ka dhënë maksimumin në këtë takim. "Ne kishim ardhur këtu për fitore. Ne patëm disa raste, por nuk i konkretizua. Unë dhashë maksimumin për këtë takim", ka thënë Muriqi, i cili më pas tregoi se lajmet për interesimin e shumë skuadrave po e motivojnë edhe më shumë. "Këto shkrime për transferime po më motivojnë më tepër. Shumë skaut po i përcjellin kudo në botë dhe kjo është natyrale", ka shtuar Muriqi. 25-vjeçari nuk

ka shprehur dëshirën që të qëndrojë për shumë vite te Fenerbahçe pasi dëshiron të bëhet legjendë e klubit. "Unë në Fenerbahçe erdha që të bëhem legjendë e ekipit. Shpresoj se këtu do të qëndrojë për shumë vite dhe do ta shkruaj emrin tim me tituj të fituar të kampionit", ka deklaruar Muriqi. Në gjashtë takimet e para në kampionat, Muriqi ka shënuar tre gola dhe ka bërë dy asistime me fanellën e Fenerbahçes.

## Hamiltoni triumfon në Rusi



MOSKË, 29 SHTATOR - Lewis Hamiltoni është fituesi i Çmimit të Madh të Rusisë, duke lënë pas vetes Bottasin dhe Leclercin. Ferrari realizoi fillim të përkryer, duke nxjerrë Sebastian Vettelin në vend të parë dhe Leclercin në të dytin, që bëri rolin e "tapës" për

Hamiltonin, që u pozicionua i treti. Në vijim pati tension mes dy pilotëve të kokëkuqes, pasi Vetteli refuzoi t'i hapte rrugën Leclercit, duke dalë jashtë planit dhe strategjisë së skuadrës. Ndërsa në xhiron e 28 Sebastian Vetteli tërhoqet nga gara për shkak të një

problemi në motor, ndërsa Hamiltoni i merr vendin e parë Leclercit, që zhvilloi dy "pit-stop" dhe piloti britanik e pati të thjeshtë ta menaxhojë garën deri në vijën e fundit. Në vend të katër u rendit Verstappenin, i ndjekur nga Albioni, Sainz dhe Perez.

### SHKURT

#### Colemani, kampioni i ri në 100 metra

Ashtu sikurse ishin edhe pritshmëritë, atleti amerikan Chris Coleman shpallet kampion i botës në garën e 100 metrave, në Botërorin e Atletikës që po zhvillohet në Doha të Katarit. 23-vjeçari e përshkoi distancën për 9 sekonda e 76 të qindta, duke shënuar kohën e 6 më të mirë në historinë e garës së 100 metrave. Medaljen e argjendtë e fitoi një tjetër atlet amerikan, ish-kampioni i botës Justin Gatlin, me kohën 9'89. Gatlin, edhe pse është në një moshë të madhe (37 vjeç), vazhdon të përformojë në nivele të larta. Vendi i tretë shkoi për atletin kanadez Andre De Grasse, që regjistroi kohën 9'90. Kujtojmë që rekordin në garën e 100 metrave e mban legjenda Usain Bolt me kohën 9'58, një kohë praktikisht e pathyeshme nga atletët e sotëm.

#### Wilderi në nëntor e mbron titullin e WBC kundër Ortizt

Është konfirmuar dueli i radhës për kampionin e WBC-së, Deontay Wilder, i cili do të rikthehet në ring gjatë muajit nëntor, për t'u përballur me Luis Ortizin. Ky duel do të jetë i dyti ndërmjet këtyre dy boksierëve, pasi më parë Wilderi e kishte mposhtur Ortizin. Boksierët do të vihen përballë njëri-tjetrit gjatë muajit nëntor, në qytetin e Las Vegasit. Në rast se Wilderi triumfon, gjasat janë të mëdha që pastaj të kemi një revansh mes Wilderit dhe Furyt.

#### Aubameyangi nuk e lë Arsenalin për Unitedin

Sulmuesi i Arsenalit, Pierre-Emerick Aubameyang, ka injoruar zërat se ai do të transferohet te Manchester Unitedi sezonin tjetër, me idenë se do të shkojë në një ekip të madh për të fituar më shumë trofe. "Unë e ndiej se gjërat po ndryshojnë dhe se në mund të fitojmë trofe tek Arsenali", ka thënë sulmuesi nga Gaboni për të përditshmen britanike "The Mirror". Aubameyang ka realizuar 48 gola në 72 ndeshje me Arsenalin. Ai shprehet se ndihet i lumtur në Londër. "Jam i bindur se mund të bëjmë më mirë këtë sezon. Të largohem? Jam i lumtur këtu, ndihem mirë. Unë dua të luaj në nivele të larta dhe fitoj trofe. Kjo është ajo që dëshirojmë të gjithë", ka shtuar Aubameyang.

#### West Hami kërkon 100 milionë paundë për Declan Rice

Declan Rice është një nga lojtarët më premtues në futbollin anglez. Mesfushori, i cili luan për West Hamin, ndiqet me interes nga shumë klube të mëdha, mes të cilave Manchester City dhe Manchester United. Por për t'i marrë shërbimet e 20-vjeçarit nuk do të jetë e lehtë, pasi drejtuesit e klubit londinez kërkojnë një shumë të madhe për ta lënë atë të lirë. "Çekanët" kanë vendosur çmimin për mesfushorin, që ka qenë pjesë e akademisë së Chelsea. Klubet që dëshirojnë ta marrin lojtarin e përfaqësueses së Anglisë duhet të paguajnë plot 100 milionë paundë, një shifër e konsiderueshme kjo duke marrë parasysh që Rice është vetëm 20-vjeçar.

#### Sanchez: Kartoni i kuq ishte i padrejtë

Alexis Sanchez sigurisht se kishte shpresuar ta festonte golin e parë me fanellën e Interit në një mënyrë tjetër dhe jo me kartonin e kuq në "Marasi" përballë Sampdorias. Nëpërmjet një postimi në "Instagram", kiliani shprehet i mërzitur që u ndëshkua me karton të kuq, teksa e quan të padrejtë. "I gëzuar për fitoren, për paraqitjen e skuadrës dhe për golin e parë, por përjashtimi me të kuq ishte i padrejtë, për mendimin tim. Tani le të shohim për ndeshjen e radhës", ka shkruar Sanchezi.

											<b>Autor: GAZMEND MORINA</b>	KËNGËTARJA NË FOTO	KAFSHË GJITARE BREJTËSE	I UJITA	TRUPI I NJERIUT NGA KOKA DERI TE KËMBËT AKTORJA ISMAILI	<b>EPOKA ERE</b>	BASHKËT.	LOCAL EDUCATION AUTHORITY	E VURA NË SITË	THEMBRA E KËPUCËS	ANËTARËSIM NË NJË PARTI POLITIKE
											PARIA E SHOQËRISË					LLOJ INSEKTI I DOBISHËM ZANORE					
											LLOJ ËMBËLSIRE						LETRARI MEKULI GJINI E LETËRSISË ARTISTIKE				
											PANDJESI						KUNDREJT FETARE ARMË E RËNDË LUFTË				
											AI QË LAHET E RREZITET LAKURIQ							RAST I BIE DERËS			
															ARTERIA MË E MADHE QË DEL NGA ZEMRA NJË (IT.)					ZANORE MARK ANTONI	
											ANALISTI SHQIPTAR NURELLARI ZANORE		"TUNIZIA" LUTJA QË BËN PRIFTI			FOSFOR, IRIDIUM JO I VJETËR			MIMOZA MUSTAFA NDËRIM ME TË CILIN RRETHOJMË OBORRIN		
KAFSHË E EGËR GJITARE (shq.)						GJUMI I THELLË (med.) FILOZOF GREK				EMBLEMA											
<b>EPOKA ERE</b>	ZË I BURRIT NDËRMJET TENORIT DHE BASIT	SHKRIMTARJA MAMAQI	SEFER (shk.)	PRINCIPATË ARABE (shq.)	BASHKËT.	"IRLANDA"		BASHKËPUNËTORI NË NJË BIZNES GJË E RRALLË E ME VLERË (Lat.)			BASHKËTISH BOKSIERI YNË LIKA										
PELLG A REZERVUAR I HAPËT PËR TË GRUMBULLUAR UJË						ILAÇ BASHKËT.		DY ZANORE SEKT I VEÇANTË I MYSLIMANËVE		TOKË E BUKËS (sh.shq.) ITALIA, LETONIA											
TRIBUNI DEMAÇI					ENË PËR TË PIER UJË (sh.shq.) AKTORI TURK IMIRZALIOGLU (shq.)			LLOJ DRURI KULTURË BUJQËSORE E ARAVE (shq.)		BETIM DEPARTMENT INDUSTRIAL RELATIONS											
EMËR MASHKULLI MYSLIMAN						TRUMCAK BASHKËT.				KA, TER GJYMTYRË E TRUPIT											
ILION LIKA			AKTORI FRANCEZ JEAN .... BASHKËT.				REGJISORJA .... ELEZI ZANORE			PORTIERI I NJOHUR BRAZILIAN "LUGANO"											
ENË E METALTË PËR TË SKUQUR VAJIN A GJALPIN					DALJE NË ZGJEDHJE RRAFSHIM, BARAZIM LARTËSISH (sh.shq.)				KËNGËTARE E JONA FEMRA E ZGJEDHUR		FINLANDA										
OHIO, NEVADA			FILMI I PARË SHQIP				E PASUR KËNGËTARJA ... KOÇI			NAIM FRASHËRI LLOJ REVOLJEJE											
NAZIFE ALAJ			LUMË NË AUSTRI AJKA E QUMËSHITIT				ORGANIZATË SEPARATISTE NË SPANJË TINGULL QË FORMOHEM NË MAJË TË GJUHËS	ZANORE EVERTON	ANITA TAKE LLOJ, SOJ	DRAMË E FRANÇESK ANTON SANTORIT	FAJDEXHI										
VEPËR KU SHËNOHESHIN VIT PËR VIT NGJARJET MË TË RËNDËSISHME TË KOHËS (sh.shq.)		BASHKËT. NJËSI PËR MATJEN E KAPACITËTIT ELEKTRIK		FUTBOLLISTI KROAT KLASNIÇ "TETOVA"				PROVIM MUNDËSI		KUNDREJT ÇIFT PARADHËNIA											
KOHË BRENDA SË CILËS DUHET TË KRYHET NJË PUNË					PJESË E ILIRISË			VEND ME KASOLLE PËR BAGËTITË (shq.)	INSTITUTE INNOVATION KNOWLEDGE DY ZANORE		"MALTA" KONFERENCË ME KARAKTER NDËRKOM-BËTAR										
KAJDE				VARIOLË DRITËRO AGOLLI			KAMPIONI AKUZUES I SOKRATIT		KALIM I TOPIT NGA NJË LOJTAR TEK TJETRI SHIU I IMËT												
LLOJ PAPANALLI				RESOR SULFUR, TANTAL						PËRPARA (bised.) AKTORI HOLLIVUDIAN ... DAMON (shqip.)											
NOTË MUZIKORE			KËNGËTARJA ANGLEZE ..... FOX IKER KASILLAS						TERRITORI I IMAMIT INDONESIA, GANA												
ALBANOL-GIA DURHAM				SOLISTJA ... FARA BASHKËT.			SHTET NË AFRIKË			ZANORE UTAH											
SHKRONJA XXVIII		QËLLIM I PARAMENDUAR, PARAMENDIM (sh.shq.)					I BËRË GATI														

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: SH, ELITA, BLET, REVA, ESAD, APAT, LAIKE, NUDISTI, TAR, DRI, AORTA, I, A, TU, PIR, MM, LUANI, KOMA, IR, ORTAKU, S, BASEN, BAR, IA, ARAT, ADEM, GOTAT, LIS, BE, REPIK, HARABEL, DEM, LI, RENO, IRIS, DIDA, TIGAN, VOTIM, LORI, ON, TANA, E KAMUR, NE, NA, INI, ETA, I, AT, M, VAN, TEST, TER, AFAT, EPIR, IRI, MA, NAZE, LI, ASI, PASIM, ARA, DIKASTER, PARA, LA, SAMANTA, IMAMAT, EDIT, ELI, NIGERI, A, T, KASTET, I GATITUR.

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**Gjeje PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook [www.facebook.com/gjejepuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejepuneshpejte)

RESTAURANT

**SWISS**

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

- Urim Dedaj shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Shtjefën Gjeqovi" Prishtinë.
- Valon Halimi shpall të pavlefshme Diplomën e shkollës fillore "Fehmi Rama" Likoc.
- Anemona Koci shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme gjimnazi "Hamëz Jashari" Skenderaj.
- Ardit Murtezi shpall të pavlefshme dëftesat e klasës VI, VII, VIII dhe IX shkolla fillore "Malush Ahmeti" Rezallë.
- Arbijos Shatri shpalle te pavlefshëm dëftesat dhe diploma e gjimnazit "Gjon Buzuku" -Romaje, Prizren.
- Urim Dedaj shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Shtjefën Gjeqovi" Prishtinë.
- Valon Halimi shpall të pavlefshme Diplomën e shkollës fillore "Fehmi Rama" Likoc.
- Anemona Koci shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme gjimnazi "Hamëz Jashari" Skenderaj.
- Ardit Murtezi shpall të pavlefshme dëftesat e klasës VI, VII, VIII dhe IX shkolla fillore "Malush Ahmeti" Rezallë.
- Arbijos Shatri shpalle te pavlefshëm dëftesat dhe diploma e gjimnazit "Gjon Buzuku" -Romaje, Prizren.
- Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.
- Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783
- Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.
- Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shihen çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.
- Shesim banesën dy dhomëshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit , çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387

**#PDK112**

**Merita  
Makolli**

**93**

*Ndërtojmë të Ardhmen*

*Për Ty dhe Shtetin*



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

